REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 1 regjistër (JD)
Datë 16.02.2022

Nr. 1 i vendimit
Datë 20.02.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji i Posaçëm i Apelimit i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	**Kryetare**
Mimoza Tasi	**Anëtare**
Ina Rama	**Anëtare**
Natasha Mulaj	**Anëtare**
Rezarta Schuetz	**Anëtare**
Sokol Çomo	**Anëtar**

– mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 1, datë 16.02.2022, që i përket:

ANKUES: Shkëlqim Kokona, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, përfaqësuar nga avokatët Fatmir Braka dhe Anteo Papa, sipas prokurës së posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.01.2022.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, përfaqësuar nga znj. Danja Hobdari dhe z. Genti Zela me autorizimin nr. {***} prot., datë 20.06.2022.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues, për vendimin nr. 411, datë 17.12.2021, për procedimin disiplinor (për përfundimin) dhe deklarimin absolutisht të pavlefshëm të masës së shkarkimit ndaj meje, dhe të raportit për hetim të subjektit, për shkelje të të drejtave të njeriut në procesin administrativ dhe për proces të parregullt ligjor, që bie ndesh me nenin 6 të Konventës së të Drejtave të Njeriut dhe një sërë nenesh të Kushtetutës së Shqipërisë. Rivendosja e të drejtave të kufizuara prej kësaj vendimmarrjeje.

BAZA LIGJORE: Nenet 28, 30, 31/1 dhe 32, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i KEDNj-së; ligji nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"; ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT,

pasi dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Mimoza Tasi, pas shqyrtimit të ankimit dhe prapësimeve të paraqitura nga magjistrati Shkëlqim Kokona, prapësimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, parashtrimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. Magjistrati Shkëlqim Kokona ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë (në vijim "ILD"), në mbështetje të neneve 120, 121, pika 2, shkronja "b" dhe 122 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me vendimin nr. {***} prot., datë 21.01.2021, ka vendosur verifikimin e ankesës nr. {***}, datë 02.11.2020, të paraqitur nga Prokurori i Përgjithshëm ndaj veprimtarisë së magjistratit Shkëlqim Kokona. Përmes kësaj ankese, është përcjellë informacion për shkelje procedurale gjatë veprimtarisë hetimore, përfaqësimit dhe ndjekjes penale në gjykim, si dhe për shkelje të normave të etikës nga ana e magjistratit.

2.1. Nga Prokurori i Përgjithshëm, është përcjellë gjithashtu në ILD ankesa e regjistruar me nr. {***} prot., datë 27.02.2020. Në këtë ankesë, nga Prokuroria e Përgjithshme është përcjellë informacioni i dërguar nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, i cili ka informuar Prokurorin e Përgjithshëm dhe anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke pretenduar në lidhje me veprimet e paligjshme, në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës së prokurorit, kompetencat e dhëna nga ligji dhe sidomos në lidhje me sjelljet aspak etike, në kufijtë e veprave penale, të prokurorit Shkëlqim Kokona.

2.2. Nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në (vijim "KLP"), është përcjellë pranë ILD-së për trajtim dhe kompetencë, informacioni i drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, regjistruar me numër ankese {***} prot., datë 08.03.2021. Ky informacion është i njëjtë me atë të dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme, regjistruar nga ILD-ja me numër ankese {***} prot., datë 27.02.2020.

2.3. Nga Prokuroria e Përgjithshme janë përcjellë pranë ILD-së edhe dy memo/ankesa të shtetasit E. K., drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, regjistruar pranë ILD-së me numër ankese {***} prot., datë 27.02.2020 (memo, datë 07.01.2020 dhe memo, datë 17.01.2020).

2.4. ILD-ja, me vendimin nr. {***} prot., datë 30.04.2021, ka vendosur bashkimin e ankesave me nr. {***} prot., datë 27.02.2020, nr. {***} prot., datë 27.02.2020 dhe me nr. {***} prot., datë 08.03.2021 në fazën e shqyrtimit fillestar, me ankesën në fazë verifikimi me nr. {***} prot., datë 02.11.2020, për t'i trajtuar ankesat sipas fazës së shqyrtimit të tyre. Në vijim, me vendimin nr. {***} prot., datë 28.05.2021, është vendosur verifikimi për ankesat nr. {***} prot., datë 27.02.2020; nr. {***} prot., datë 27.02.2020; dhe nr. {***} prot., datë 08.03.2021.

2.5. Pas kryerjes së verifikimeve, ILD-ja, me vendimin nr. {***}, datë 11.06.2021, "Për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë", ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit Shkëlqim Kokona, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, germa "b", nënpika "ii", dhe pika 2, germa "dh" e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (në vijim "ligji 96/2016"). Me vendimin nr. {***}, datë 30.07.2021, ILD-ja ka vendosur shtimin e objektit të hetimit edhe për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 148/d, pika 2, germa "a" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, germat "ç", "d", "dh", "g", dhe pika 2, germat "a" dhe "dh" të ligjit nr. 96/2016.

3. KLP-ja ka administruar me nr. {***}, datë 11.10.2022, kërkesën e ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit Shkëlqim Kokona, së bashku me propozimin për caktimin e masës disiplinore *Shkarkim nga detyra*, të parashikuar nga neni 111 i ligjit nr. 96/2016, shoqëruar me vendimin e ILD-së për përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit Shkëlqim Kokona, raportin e hetimit disiplinor nr. {***}, datë 11.10.2021, si dhe dosjen hetimore.

4. KLP-ja, në përfundim të procedimit disiplinor, me vendimin nr. 411, datë 17.12.2021 (në vijim vendimi nr. 411/2021), ka vendosur: *1. Të pranojë kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor nr. {***}, datë 11.10.2021, për prokurorin Shkëlqim Kokona, për shkelje të rënda profesionale që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës, parashikuar nga neni 148/d, pika 2, germa "a" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, germa "b", nënpika "ii", neni 102, pika 1, germat "ç", "d", "dh", "g" dhe neni 102, pika 2, germat "a" dhe "dh" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. 2. Dhënien e masës disiplinore "Shkarkimin nga detyra" për magjistratin Shkëlqim Kokona, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec. 3. Pezullimin e përfitimit të pagës në masën 50%, si dhe përfitimet e tjera derisa vendimi të marrë formë të prerë. 4. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe z. Shkëlqim Kokona brenda 5 (pesë) ditëve nga data e shpalljes. 5. Të njoftohet Prokurori i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi, si dhe Prokuroria e Shkallës së Parë Pogradec. 6. Kundër vendimit lejohet ankim sipas ligjit në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese brenda afatit të përcaktuar nga neni 50, pika 4 e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", i ndryshuar, afat i cili fillon nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.*

5. Kundër vendimit nr. 411/2021 të KLP-së, ka ushtruar ankim magjistrati Shkëlqim Kokona, duke kërkuar pranimin e ankimit si të bazuar në ligj e në prova, shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 411, datë 17.12.2021, "Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistratit Shkëlqim Kokona, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, kthimin në detyrë dhe kompensimin e pasojave financiare. Ankimi i magjistratit së bashku me shtesën e ankimit të paraqitur prej tij, është regjistruar në Kolegj në Juridiksionin Disiplinor me (JD) nr. 1/2022.

6. Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, në kuptim të nenit 31/a, pika 1 e ligjit nr. 8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (në vijim "ligji nr. 8577/2000"), nuk arriti të marrë njëzëri vendim lidhur me kalimin e çështjes në seancë plenare dhe sipas parashikimeve të nenit 31, pika 3 e këtij ligji, kërkesa e paraqitur nga magjistrati Shkëlqim Kokona, i kaloi për shqyrtim paraprak Mbledhjes së Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Mbledhja e

Gjyqtarëve, pasi e bisedoi çështjen, konkludoi se plotësohen kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga nenet 27, 31, 31/a dhe 71/a për shqyrtimin në seancë plenare të ankimit të magjistratit Shkëlqim Kokona dhe, bazuar në nenin 21, pika 1 e ligjit nr. 8577/2000, me vendimin 1/1, datë 16.05.2022, vendosi: *Kalimin e çështjes (JD) nr. 1/2022, datë 16.02.2022, që i përket ankimit të magjistratit Shkëlqim Kokona ndaj vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 411, datë 17.12.2021, për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Të thirret si person i interesuar Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë me kërkesën për përcjellje të fashikullit të procedimit disiplinor për magjistratin Shkëlqim Kokona.*

7. Vendimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 1/1, datë 16.05.2022, iu përcoll magjistratit dhe përfaqësuesve të tij ligjorë, me shkresat nr. {***} dhe {***}, datë 18.05.2022. Palëve të interesuara, KLP-së dhe ILD-së, së bashku me vendimin e sipërcituar, iu përcollën kopje të ankimit dhe materialeve bashkëlidhur tij, të shtesës së ankimit, të paraqitur nga magjistrati Shkëlqim Kokona, si dhe iu kërkua të paraqesin parashtrimet në kuadër të gjykimit në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve të çështjes nr. 1, datë 16.02.2022, me kërkues magjistratin Shkëlqim Kokona[1].

7.1. KLP-ja[2] përcolli në Kolegj prapësimet e nënshkruara nga të autorizuarit prej kryetarit të KLP-së, z. Alfred Balla, për përfaqësimin e institucionit në gjykimin e kësaj çështjeje, znj. Danja Hobdari dhe z. Gerti Zela[3], fashikullin e procedimit disiplinor që i përket vendimit nr. 411/2021 "Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistratit Shkëlqim Kokona", shoqëruar me inventarin përkatës[4]. ILD[5]-ja përcolli në Kolegj parashtrimet dhe shpjegimet për këtë çështje, nënshkruar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani.

7.2. Prapësimet e KLP-së dhe parashtrimet ILD-së iu përcollën magjistratit dhe përfaqësuesve të tij ligjorë, shkresa nr. {***} prot., datë 27.06.2002. Përfaqësuesi ligjor i magjistratit, z. Anteo Papa, paraqiti kërkesa për njohje me aktet e realizuara në Kolegj gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës së të përfaqësuarit prej tij[6], e cila u disponua prej Kolegjit me shkresat nr. {***} prot., datë 14.06.2022 dhe {***} prot., datë 20.07.2022.

7.3. Kolegji, me shkresat {***} dhe {***}, datë 18.01.2023, njoftoi magjistratin dhe përfaqësuesit e tij ligjorë për zhvillimin e seancës plenare mbi bazë të dokumenteve në datë 20.02.2023, ora 10:00, si dhe për depozitimin prej tij të kërkesave/parashtrimeve jo më vonë se 10 ditë përpara datës së seancës. Përfaqësuesi ligjor i magjistratit, z. Anteo Papa, përmes postës elektronike konfirmoi marrjen dijeni, si dhe paraqiti kërkesë për njohje me fashikullin e plotë dhe

---

*[1] Shkresat me nr. {***} prot., dhe nr. {***} prot., datë 19.05.2022.*

*[2] Shkresa nr. {***} prot., datë 20.06.2022, administruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 20.06.2022.*

*[3] Autorizim nr. {***} prot., datë 20.06.2022, me të cilin autorizohen dy përfaqësuesit që, bashkërisht ose veçmas, të nënshkruajnë prapësimet dhe të përfaqësojnë KLP-në në gjykimin e çështjes (JD) nr. 1/2022.*

[4] Inventari i akteve të hetimit disiplinor të magjistratit Shkëlqim Kokona, viti 2021 – dosja nr. 1: në total 1385 fletë, 2 CD dhe 6 fletë lista e inventarit; dosja nr. 2: në total 1273 fletë dhe 2 fletë lista e inventarit; dosja nr. 3: në total 947 fletë dhe 1 fletë lista e inventarit; dosja nr. 4: në total 773 fletë dhe 1 fletë lista e inventarit; dosja nr. 6: në total 1950 fletë dhe 4 fletë lista e inventarit.

*[5] Shkresa nr. {***} prot., datë 20.06.2022, administruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 20.06.2022, nëpërmjet së cilës ILD-ja informon se, në zbatim të nenit 138, pika 1 e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dosja hetimore origjinale, së bashku me raportin e hetimit dhe kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit Shkëlqim Kokona, është paraqitur pranë KLP-së me shkresën nr. {***}, datë 11.10.2021.*

*[6] Shkresat nr. {***} prot., datë 25.01.2023 dhe nr. {***}, datë 8.02.2023.*

me të gjitha aktet e administruara dhe të krijuara në funksion të procedimit disiplinor, në bazë të të cilave është marrë vendimi objekt ankimi dhe, pas këqyrjes së tyre më datë 08.02.2023, paraqiti kërkesë për vënie në dispozicion të një pjese të dokumentacionit dhe të materialit në format elektronik[7]. Sipas kërkesës, përfaqësuesit ligjor të magjistratit, z. Anteo Papa, iu përcollën kopje të dokumentacionit të kërkuar me shkresën nr. {***} prot., datë 10.02.2023.

I. Pretendimet e magjistratit Shkëlqim Kokona në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

8. Magjistrati Shkëlqim Kokona, sipas parashikimeve të nenit 38, pika 6 e ligjit nr. 8577/2000, paraqiti në Kolegj parashtrimet dhe qëndrimin e tij ndaj vendimit nr. 411, datë 17.12.2021, të KLP-së dhe ndaj prapësimeve të KLP-së dhe parashtrimeve të ILD-së. Në parashtrimet e tij, të administruara në Kolegj me nr. {***} prot., datë 10.02.2023, magjistrati ka paraqitur të njëjtat argumente dhe qëndrime të pasqyruara si në ankim. Shkaqet e ankimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si vijon.

8.1. *Shkaqet e ankimit lidhur me procedurën e hetimit dhe të shqyrtimit të çështjes në ILD dhe KLP*

8.1.1 Magjistrati Shkëlqim Kokona kundërshton si antikushtetues vendimin nr. 411, datë 17.12.2021, të KLP-së, duke pretenduar se është një vendimmarrje në keqzbatim të parimeve kushtetuese, në kundërshtim të hapur me praktikën e Gjykatës Kushtetuese dhe të garancive e parimeve të mbrojtura nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim "KEDNj"). Sipas magjistratit, një pjesë e veprimtarisë së hetuar disiplinarisht nga ILD-ja përkon me një periudhë kohore kur nuk mund të aplikoheshin parashikimet e shkeljeve disiplinore të përcaktuara në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pasi këto dispozita ishin shfuqizuar nga vendimi nr. 34/2017 i Gjykatës Kushtetuese.

8.1.2. KLP-ja ka cenuar parimet e procesit të rregullt ligjor, pasi procesi dëgjimor është realizuar në mungesë të mbrojtësit të magjistratit, pavarësisht kërkesës së tij për sigurimin e mbrojtjes me avokat, si dhe në mungesë të palës kërkuese, pasi subjektet e pranishme nuk kishin legjitimitet për të përfaqësuar kërkuesin, ILD-në, në kuptim të nenit 204 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" (në vijim "ligji 115/2016"). Magjistrati pretendon se në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar (në vijim "ligji 49/2012"), në arsyetimin e vendimit të KLP-së nuk ka asnjë referim në çmuarjen e pohimeve gjyqësore të tij.

8.1.3. KLP-ja nuk ka mbajtur qëndrim në lidhje me veprimtarinë e ILD-së, për inicimin e një hetimi me iniciativë pa pasur bazueshmërinë ligjore për të vlerësuar, mbështetur në ligjin referues, faktet e pretenduara si shkelje të rënda profesionale, në kundërshtim me nenin 41 të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", që sanksionon: *Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor*, dhe bie ndesh haptazi me parashikimin në po të njëjtin nen se: *Organi publik është i detyruar të fillojë procedurën*

*[7] Përfaqësuesi ligjor i magjistratit paraqiti në Kolegj, kërkesë me nr. {***} prot., datë 08.02.2023, për vënie në dispozicion, sipas inventarit të dosjes procedimit disiplinor të KLP-së, kopje të dokumentacionit sipas numërtimit përkatës; si dhe kopje të CD-ve të administruara.*

administrative kryesisht, kur: a) ligji ose akti nënligjor parashikojnë fillimin e procedurës. Në kuptimin e *rationea temporis*, ligji material kufizon fillimin e kësaj procedure nisur nga fakti se dispozitat ligjore për shkeljet disiplinore të pretenduara, në raport me kohën kur ka ndodhur fakti i pretenduar, janë shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34/2017. Sipas magjistratit, aplikimi i normave me frymë të përgjithshme kur në rastin konkret ligji i posaçëm përfshin aplikimin e normave specifike dhe veprimtaria objekt gjykimi nuk konsiderohet shkelje nga ligji material nr. 96/2016, përbën cenim të sigurisë juridike.

8.1.4. KLP-ja nuk ka mbajtur qëndrim në lidhje me afatet dhe procedurat e ndjekura nga ILD-ja, për fillimin e hetimit disiplinor në tejkalim të afateve të parashikuara nga neni 118 i ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim "ligji 96/2016"), dhe për sa rezulton se nuk ka asnjë provë shkresore për marrjen dijeni prej tij për vendimin nr. {***} prot., datë 30.07.2021, me të cilin është vendosur shtimi i objektit të hetimit disiplinor, me pasojë heqjen e mundësisë së kundërshtimit të këtij vendimi.

8.1.5. Hetimi administrativ disiplinor është kryer nga ILD-ja në shkelje të Kushtetutës dhe të KEDNj-së, nenit 6 të saj, lidhur me procesin e rregullt ligjor, pasi sipas magjistratit, nuk i është dhënë mundësia e mbrojtjes me "avokat", shkak për të cilin ka qenë në pamundësi për kundërshtimin e materialeve, për verifikimin dhe kundërshtimin e provave, për verifikimin dhe pyetjen e dëshmitarëve. Sipas tij, nuk janë lejuar të hulumtohen nga mbrojtja shkeljet e rënda procedurale gjatë procesit të të provuarit, si përdorimi i dëshmisë së rreme, kryerje e hetimit administrativ për të dënuar një person të padëshiruar për motive ku përfshihen edhe ato politike. Magjistrati pretendon se është cenuar e drejta për t'u njohur sa më shpejt me natyrën dhe shkakun e akuzës administrative, është cenuar e drejta për t'u dëgjuar përpara inspektorit të përgjithshëm ose inspektorëve që kanë kryer hetimin administrativ, është cenuar e drejta për një proces pa shtyrje të panevojshme, për lehtësitë dhe dhënien e një kohe të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes, është cenuar parimi i ndalimit të vetinkriminimit, si dhe është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë. Magjistrati shprehet se *paraprakisht ka kërkuar pranë Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin si antikushtetues të vendimit për përfundimin e hetimit disiplinor dhe deklarimin relativisht të pavlefshëm, si antikushtetues, të raportit të hetimit disiplinor.*

8.2 *Shkaqet e ankimit lidhur me vendimmarrjen e KLP-së*

8.2.1 Për procedimet penale për të cilat është proceduar disiplinarisht nga KLP-ja, magjistrati pretendon se shkeljet e rënda profesionale janë fiktive dhe të rreme, provat e paraqitura vërtetojnë profesionalizmin dhe pafajësinë e tij, për një numër të konsiderueshëm të procedimeve penale, vendimet e tij janë në fuqi dhe i ka fituar në apel. Shkaqet e ankimit lidhur me vendimmarrjen e KLP-së, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si vijon.

8.2.2 Lidhur me konkluzionin e KLP-së për refuzimin për të marrë në dorëzim dosjet ose materialet kallëzuese të caktuara nëpërmjet procedurës së shortit, magjistrati pretendon se ka bërë debat për shkak të ngarkesës të tij, 450 çështje ose 2/3 e ngarkesës së Prokurorisë, shkak për të cilin u caktua nga KLP-ja prokurori i komanduar dhe kërkon që nga ana e Kolegjit të mbahet parasysh informacioni i tij për prokurorin e Prokurorisë së Përgjithshme A. Ç., lidhur me veprimet korruptive të prokurorit S. K., sipas tij për shpërdorim detyre dhe dyshime të forta për korrupsion pasiv.

8.2.3 Lidhur me konkluzionin e KLP-së për mospjesëmarrje në mënyrë të vullnetshme në seanca gjyqësore apo për refuzimin me veprime aktive të vendimit të gjykatës për të ngritur akuzë ndaj personit në hetim, dhe pas ngritjes së akuzës, mbrojtjen e saj në gjykim, duke u bërë shkak për zvarritje të gjykimit, magjistrati ngre pretendime se janë çështje të fituara nga ana e tij, ose që lidhen, sipas tij, me aferë korruptive të prokurorit S. K., avokatit Th. S., gjyqtarit A. J. dhe redaktorit të emisionit "{***}", ose pretendon se ka qenë me leje në Tiranë.

8.2.4 Lidhur me konkluzionin e KLP-së për refuzim nga ana e tij për të shpallur moskompetencën për procedimin penal nr. {***}, datë 24.02.2019, magjistrati pretendon se konflikti i kompetencës mes Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është zgjidhur në bazë të ligjit nga Prokurori i Përgjithshëm, se nuk ka bërë asnjë shkelje ligjore, procedurale apo materiale, dhe as të akteve të Prokurorit të Përgjithshëm.

8.2.5 Lidhur me konkluzionin e KLP-së për përfundim me vendim pushimi nga ana e tij të çështjeve penale të regjistruara për vepra penale që kualifikohen si krime, magjistrati pretendon se këto procedime janë pushuar prej tij pasi dispozitat përkatëse i kualifikojnë ato si kundërvajtje penale dhe se vendimet janë në fuqi.

8.2.6 Lidhur me konkluzionin e KLP-së për refuzimin me anë të mosveprimit, për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit për vendimet e gjykatës për të cilat parashikohet ekzekutim i menjëhershëm, vendimin penal nr. {***}, datë 16.12.2019, dhe vendimin nr. {***} datë 09.01.2020, si dhe mosveprimit në 28 raste për nxjerrjen e urdhrit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore me kusht sipas nenit 59 të Kodit Penal, magjistrati pretendon se në bazë të urdhrit të Prokurorit të Përgjithshëm, veprimet bëhen nga një prokuror i caktuar, se ka qenë e ngarkuar prokurore D. B., dhe se për vendimin penal {***}, datë 16.12.2019, urdhri i ekzekutimit është nxjerrë nga titullari me tri ditë vonesë.

8.2.7 Lidhur me konkluzionin e KLP-së për shkelje të përsëritur dhe të rëndë të normave të sjelljes dhe solemnitetit, rregullave të mirësjelljes në marrëdhëniet me drejtuesit e prokurorisë, oficerët e policisë gjyqësore, personelin e administratës së prokurorisë, gjyqtarët, palët apo avokatët e tyre, magjistrati pretendon se ankesat dhe dëshmitë për fyerje apo kanosje prej tij janë shpifje, pasi ndaj tij nuk ka të depozituar asnjë padi civile për fyerje apo kallëzim penal, në seancat gjyqësore ka pasur debat profesional normal, të zakonshëm mes palëve, pa asnjë shkelje nga ana e tij, avokatët kanë bërë presion të hapur apo provokime ndaj tij në seancë gjyqësore.

9. Lidhur me aktet shkresore të depozituara me ankimin, të cilat magjistrati Shkëlqim Kokona kërkon të merren në cilësinë e provës[8], sa u përket analizave vjetore të treguesve të punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, Kolegji konstaton se ato janë paraqitur nga ankuesi

[8] *Magjistrati, bashkëlidhur ankimit, ka paraqitur "Analiza e treguesve të punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec për vitin 2019", me nr. {***} prot., datë 28.02.2020; "Analiza e treguesve të punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec për vitin 2018", me nr. {***} prot., datë 28.02.2019; "Analiza e treguesve të punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec për vitin 2017"me nr. {***} prot., datë 08.02.2018"; "Analiza e treguesve të punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec për vitin 2016, me nr. {***} prot., datë 27.02.2017; "Ngarkesa e punës për prokurorin Shkëlqim Kokona për vitet 2016-2020, referuar të dhënave statistikore të analizave vjetore të viteve 2016-2020" me emër, mbiemër dhe nënshkrim të A. Zh. dhe Dh. Z. [sekretare dhe kryesekretare në Prokurori], si dhe vulë me specimen: "Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec - Sekretaria".*

gjatë procedimit disiplinor dhe janë administruar nga KLP-ja. Për më tepër, në këto dokumente, në nëndarjen ku pasqyrohet ngarkesa vjetore e çështjeve për prokurorët, nuk rezulton që magjistrati Shkëlqim Kokona të ketë pasur një ngarkesë më të madhe krahasuar me prokuroren D. B., apo me prokurorët e komanduar për periudha të caktuara kohe në këtë prokurori. Gjithashtu, dokumenti "Ngarkesa e punës për prokurorin Shkëlqim Kokona për vitet 2016-2020 – referuar të dhënave statistikore të analizave vjetore të viteve 2016 - 2020", referon vetëm të dhëna numerike. Për sa më sipër, Kolegji, bazuar në nenin 213 të Kodit të Procedurës Civile, vendosi të mos i marrë këto dokumente në cilësinë e provës së re, aq më tepër kur të dhënat nuk afektojnë zgjidhjen e çështjes.

10. *Prapësimet e KLP-së lidhur me shkaqet e paraqitura nga magjistrati në ankim*

10.1. *Mbi pretendimet për karakterin antikushtetues të vendimit*

10.1.1 *Mbi pretendimin për cenim të së drejtës së përfaqësimit*

Referuar parashikimeve të neneve 33-39 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" (në vijim "ligji 44/2015"), KLP-ja ka respektuar detyrimin e parashikuar në ligjin e posaçëm nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim "ligji 96/2016"), për të njoftuar subjektin e procedimit disiplinor për të drejtën e përfaqësimit dhe ky i fundit nuk është paraqitur me përfaqësues në seancë dëgjimore. KLP-ja nuk ka pasur detyrimin që t'i caktonte përfaqësues kryesisht, pasi nuk ndodhej në rastet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit 44/2015. Në kuptim të nenit 22 të Kodit të Procedurës Civile, që përcakton se palët mund të mbrohen vetë, përveçse kur përfaqësimi është i detyrueshëm, ka qenë e drejta e zgjedhjes së subjektit të procedimit disiplinor për t'u vetëpërfaqësuar dhe për të ndërtuar vetëmbrojtjen e interesave të tij në seancë dëgjimore. Për sa kohë prej subjektit të procedimit disiplinor nuk është shfrytëzuar kjo e drejtë, nuk mund t'ia kundërdrejtojë KLP-së si detyrim për t'u zbatuar, pasi prej saj ligji është aplikuar në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

10.1.2. *Mbi pretendimin për cenim të së drejtës për t'u dëgjuar drejtpërdrejt nga gjykata, për shkak të zhvillimit të seancës dëgjimore on-line*

Bazuar në rregulloren "Për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të administratës shtetërore gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga Covid 19", miratuar më datë 23.10.2020, me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm të KLP-së, nenit 6 të saj, ku parashikohet se vetëm në rastin kur mbledhja nuk mund të zëvendësohet nga një video-konferencë, mund të bëhet i mundur takimi ballë për ballë, e duke qenë se numri i pjesëmarrësve në seancë dëgjimore ishte i madh [8 anëtarë të KLP-së, 2 përfaqësues të ILD-së dhe vetë magjistrati], ekzistonin të gjithë kushtet që seanca dëgjimore të zhvillohej *on-line*, dhe nuk kishte arsye specifike për të cilat të nevojitej ballafaqimi i palëve në prezencë fizike. Në seancën dëgjimore janë respektuar të gjitha rregullat procedurale, sikundër në prezencën fizike të palëve: kuorumi dhe pjesëmarrja e anëtarëve, legjitimimi i palëve, kërkesat paraprake, dhënia e mendimit të ILD-së për këto kërkesa, dhënia e vendimeve të ndërmjetme për kërkesat, administrimi i provave të reja dhe pranueshmëria e tyre, parashtrimi i fakteve nga relatori, prapësimet e subjektit të procedimit disiplinor, prapësimet e ILD-së dhe mbyllja e seancës dëgjimore, për rrjedhojë palët janë dëgjuar drejtpërsëdrejti nga KLP-ja, sikundër përcakton neni 24 i K.Pr.C.: *Gjykata dëgjon palët drejtpërsëdrejti, përveç kur ligji parashikon ndryshe*, duke respektuar rrethanat në të cilat ndodhej vendi, si dhe duke respektuar të gjithë standardet që kërkon procesi i rregullt ligjor. Në referim të nenit 40, pika 4 e ligjit 49/2012, edhe nëse zhvillimi i seancës dëgjimore *on-line* do të konsiderohej

shkelje procedurale nga ana e Kolegjit, sërish ky shkak ankimi duhet të rrëzohet pasi edhe në rast të zhvillimit të seancës dëgjimore me prani fizike të palëve, pasojat do të ishin të njëjta.

10.1.3. *Mbi pretendimin se baza ligjore e shkeljeve disiplinore nuk ka qenë në fuqi, pra ka një boshllëk legjislativ, për pasojë janë cenuar nenet 6 dhe 7 të KEDNj-së*

Kushtetuta e ka veshur prokurorin me kompetenca për të ushtruar ndjekjen penale, si dhe për të përfaqësuar akuzën në gjyq në emër të shtetit, për të garantuar një sistem të një drejtësie penale funksionale, dhe si çdo funksion tjetër, prokurori duhet të mbajë përgjegjësi në rast se përbën kërcënim për shtetin e së drejtës dhe rendin kushtetues. Kushtetuta përmban dispozita që rregullojnë zbatimin e saj në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Në lidhje me nenin 4/3 të Kushtetutës, që parashikon: *Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe*, ndër vite Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se sipas këtij parimi themelor, kur rregulli kushtetues parashikohet shprehimisht, ai nuk mund të mënjanohet e as të tejkalohet. Referuar analizës gjuhësore dhe logjike të nenit 148/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, rregullimi kushtetues i parashikuar shprehimisht prej saj, detyrimisht do të zbatohet drejtpërdrejt. Kushtetuta nuk ka pasur qëllim të autorizojë ligjvënësin të parashikojë rastet e shkarkimit të prokurorit, pasi këtë ajo e ka bërë nëpërmjet nenit 148/d, pika 2 e saj[9], ndërsa sa i përket dhënies së masave të tjera disiplinore, po ky nen, në pikën 1 të tij, ia ka deleguar kompetencat ligjvënësit për të parashikuar rastet dhe kriteret e zbatimit të tyre. Shfuqizimi i dispozitës ligjore ku ndër të tjera janë listuar masat disiplinore, nuk krijon boshllëk ligjor sepse mund të aplikohet drejtpërdrejt neni 148/d, pika 2 e Kushtetutës.

10.1.3.1. Në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese është interpretuar përfundimisht koncepti i shkeljes së rëndë, në kontekst të neneve 128, 140 dhe 149, pika 2 e Kushtetutës, sipas të cilëve shkelja e rëndë ka të bëjë me akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit e të prokurorit, si dhe shkelje të rënda të ligjit nga Prokurori i Përgjithshëm, duke pohuar se ajo duhet të analizohet dhe vlerësohet në tërësi, bazuar në disa faktorë. Ndryshimi i nenit 148 të Kushtetutës me ligjin nr. 76/2016, ka saktësuar dinamikat e reja shoqërore në kontekstin disiplinor ndaj magjistratëve, duke ruajtur konceptin e "sjelljes që diskrediton rëndë pozitën dhe figurën e magjistratit". Sa i takon interpretimit përfundimtar dhe të detyrueshëm të shprehjes "akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën [...]", në vendimin e KLP-së referohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 75, datë 19.04.2002[10]. Sipas nenit 132, pika 1 e Kushtetutës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme, *ndikimi i vendimeve të gjykatës është i tillë që u imponon të gjitha organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të tyre*[11]. Fuqia detyruese e vendimeve të mëparshme të Gjykatës Kushtetuese është e lidhur me çështjet konkrete të shqyrtuara, por edhe me interpretimin

---

[9] Neni 148/d i Kushtetutës, i shtuar me ligjin 76/2016, datë 22.7.2016, përcakton se: "1. Prokurori mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit. [...] 2. Prokurori shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës; b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi [...]".

[10] Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 75, datë 19.04.2002, ku është analizuar se: "[...] veprime ose mosveprime, që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momentit subjektiv, si dhe dëmeve që i sjellin shoqërisë e shtetit, janë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese nga këto subjekte. Këto shkelje marrin karakterin e rëndë të tyre lidhur ngushtë me rëndësinë e ligjit të shkelur, pasojat e ardhura ose që mund të vinin nga shkelja, frekuencën e shkeljes, kohëvazhdimin e pasojave dhe të vështirësive për riparimin e tyre, si edhe qëndrimin subjektiv që mban autori i shkeljes kundrejt saj dhe pasojës së ardhur [qëndrim i rikonfirmuar në vendimin e kësaj gjykate nr. 1/2022, pika 138].

[11] Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 14, datë 03.06.2009.

e bërë nga gjykata në pjesën arsyetuese. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues, ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe kanë efektet e forcës së ligjit. Prandaj, edhe në rastet shfuqizimit të ligjeve apo boshllëqeve ligjore të krijuara nga shfuqizimet kushtetuese, interpretimet e mëparshme të Gjykatës Kushtetuese, në pjesën arsyetuese të tyre janë të përdorshme, përbëjnë interpretim përfundimtar dhe janë të detyrueshme për të gjithë.

10.1.3.2. Shkarkimi i prokurorit nga detyra është një sanksion kushtetues i posaçëm dhe nuk është pasojë e një përgjegjësie penale. Referuar praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, (në vijim "GjEDNj"), nocioni "vepër penale" ka kuptim autonom, i cili evidentohet në plotësimin e trefishtë të kritereve të Engelit[12] për t'u marrë në konsideratë e për të përcaktuar nëse gjendemi përballë një akuze penale në kuptim të nenit 6, dhe që duhet të zbatohet edhe neni 7 i KEDNj-së[13].
Për kriterin e parë, klasifikimin e brendshëm të veprës, shkarkimi i prokurorit ka natyrë disiplinore, e parashikuar në Kushtetutë dhe rregullohet nga ligjet 96/2016 dhe 44/2015, sipas rastit. Në asnjë moment procedural nuk është referuar apo përmendur zbatimi i Kodit Penal apo Kodit të Procedurës Penale.
Për kriterin e dytë, natyra e veprës, dispozitat kushtetuese të shkarkimit janë të një natyre disiplinore që lidhen me shkelje profesionale ose etike, nuk janë me natyrë kriminale, fakti që një veprim ose një mosveprim mund të çojë potencialisht në të ardhmen në një sanksion disiplinor por edhe penal, nuk është i mjaftueshëm për ta bërë një person në një proces disiplinor si të akuzuar për një krim. Që neni 6 i KEDNj-së mund të gjejë aplikim nën aspektin penal të tij, do të ishte vetëm në kontekstin e ndonjë procedimi penal më vete në të ardhmen, i cili mund të ngrihet kundër kërkuesit.
Për kriterin e tretë, shkalla e ashpërsisë së dënimit, KLP-ja vëren se shkarkimi nga detyra është sanksion karakteristik i një vepre disiplinore dhe nuk mund të ngatërrohet me dënimin penal. Në vendimin e KLP-së nuk shfaqet ndonjë masë plotësuese ose alternative nga Kodi Penal, fakti që shkarkimi nga detyra është i natyrës së përhershme, nuk mjafton për ta konsideruar si ndëshkim penal. KLP-ja vlerëson se elementet e mësipërme, të marra në mënyrë alternative apo kumulative, janë të pamjaftueshme për të arritur në përfundimin se nenet 6 dhe 7 të KEDNj-së janë të pazbatueshme nën aspektin e tyre penal dhe, për rrjedhojë, pretendimi për boshllëk legjislativ, në kontekst të mosdënimit pa ligj, duke cenuar nenet 6 dhe 7 të KEDNj-së, ka papajtueshmëri *ratione materiae* dhe për këtë arsye, nuk duhet pranuar.

10.1.3.3. Vendimmarrja e KLP-së nuk mund të jetë antikushtetuese për sa kohë, për shkelje që i përkasin periudhës 18.04.2017 – 20.08.2019, i referohet drejtpërdrejt Kushtetutës. Për më tepër, shkeljet e subjektit të procedimit disiplinor përfshijnë periudhën 2018 - 2021, që do të thotë se për një pjesë të konsiderueshme të tyre, kishin hyrë në fuqi dispozitat e reja ligjore. Ndonëse pika 2 e nenit 101 të ligjit 96/2016 është ndryshuar me ligjin 48/2019, dhe nuk ka qenë në fuqi në kohën kur kanë ndodhur një pjesë e fakteve objekt procedimi disiplinor, përcaktimet e saj janë marrë në analizë, me qëllim që subjekti i procedimit disiplinor të mos gjendet në pozitë më pak të favorshme se çdo prokuror tjetër, veprimet/mosveprimet e të cilit mund të jenë kryer pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit 48/2019, për t'u vlerësuar nëse përbënin shkelje disiplinore, ku përveç parashikimeve kushtetuese, do të merreshin në konsideratë edhe faktorët e sipërcituar. Ky interpretim referohet në nenin 120, pika 1, germa "dh" e ligjit 96/2016. Faktet e provuara gjatë procedimit disiplinor, të

[12] Referojuni vendimeve të GjEDNj-së, çështjet Engel me të tjerë kundër Vendeve të Ulëta; Xhoxhaj kundër Shqipërisë.
[13] Referojuni vendimeve të GjEDNj-së, çështjet Brown kundër Mbretërisë së Bashkuar; Societe Oxygene Plus kundër Francës; Zhaja kundër Kroacisë.

cilat adresohen ndaj sjelljes së magjistratit Shkëlqim Kokona, parashikohen si shkelje disiplinore nga neni 148/d, pika 2, germa "a" e Kushtetutës së RSh dhe nga neni 101, pika 1, germat "a" dhe "b", neni 102, pikat 1, germa "b", nënpika "ii", germat "c", "d", "dh", "g" dhe pika 2, germat "a" dhe "dh" të ligjit 96/2016. Në këtë kontekst, pretendimi i ankuesit që KLP-ja ka keqinterpretuar parimin e specialitetit dhe konceptin e rezervës ligjore, nuk qëndron dhe nuk duhet të merret parasysh nga Kolegji.

10.4 *Lidhur me pretendimin se KLP-ja nuk ka analizuar veçmas çështjet e procedimit disiplinor dhe i ka pranuar "en bloc" të gjitha pretendimet pa asnjë rezervë*

KLP-ja prapëson se nga vendimi del qartë që ka marrë në shqyrtim çdo rast shkeljeje, nën spektrin e legjislacionit që ka qenë në fuqi, duke evidentuar rastet që i është referuar drejtpërdrejt Kushtetutës, dhe rastet kur i është referuar ligjit 96/2016. Në analizë të kriterit "lloji dhe rrethanat e çështjes", në raport me faktet e provuara gjatë procedimit disiplinor, rezulton se pas një vlerësimi të hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjithë provave së bashku, konstatohet se prokurori Shkëlqim Kokona:

10.4.1 Në më shumë se 15 raste nuk ka përmbushur funksionet e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e çështjeve në gjyq, duke mos pranuar të merrte në dorëzim dosjet e procedimeve penale, me pretendime të pashoqëruara me argumente bindëse si shkaqe dorëheqjeje, lënien e tyre pa veprime hetimore dhe duke mos u paraqitur në seancat gjyqësore të njoftuara zyrtarisht nga gjykata, duke vepruar në kundërshtim me nenet 24, 25 dhe 304 të Kodit të Procedurës Penale, nenin 3 të ligjit 96/2016, nenet 4, 5, 6 dhe 11 të Ligjit për Prokurorinë, duke qenë para elementeve të shkeljes disiplinore të parashikuar në nenin 102, pika 1, germa "ç", neni 102, pika 1, shkronja "b"/ii e ligjit 96/2016. Lidhur me procedimin penal nr. 57/2019, mosveprimet e prokurorit Shkëlqim Kokona përbëjnë mospërmbushje të rregullt të funksionit sipas parashikimeve të neneve 76 dhe 28 të Kodit të Procedurës Penale, dhe do të përbënin shkelje sipas parashikimeve të nenit 102, pika 1, shkronjat "c" dhe "d" të ligjit 96/2016, dispozitë e cila ka hyrë në fuqi me ligjin 48/2019, në mungesë të saj ka qenë i zbatueshëm parashikimi kushtetues në nenin 148/d të Kushtetutës. Sjellja profesionale e prokurorit në këtë rast vlerësohet në raport edhe me shkeljet e tjera objekt hetimi, të periudhës 2018 - 2021.

10.4.1 Ka vepruar në kundërshtim me ligjin procedural penal, i cili parashikon se në rast se procedohet për krime, prokurori i drejtohet me kërkesë gjykatës kur vlerëson se duhet të vendoset pushimi i procedimit penal. Në cilësinë e prokurorit, me vendimin e tij, ka vendosur pushimin e procedimeve penale të regjistruara për vepra penale të parashikuara nga nenet 130/a/1, 199/a/1, 290/1 të Kodit Penal, vepra të cilat konsiderohen të jenë krime referuar përcaktimit të nenit 1 të Kodit Penal, për llojin e veprave penale. Veprimet e prokurorit për marrjen e vendimit të pushimit, vlerësohen në raport me kohën e hyrjes në fuqi të ligjit 48/2019. Për procedimet penale nr. 24/2018 dhe nr. 459/2018, veprimi i prokurorit lidhur me marrjen e vendimit të pushimit, referuar parashikimit të nenit 148/d të Kushtetutës, vlerësohet në kundërshtim me nenet 24, 25, 328, 329/a të Kodit të Procedurës Penale dhe konsiderohen se përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit procedural penal në drejtim të ushtrimit të ndjekjes penale dhe të kontrollit gjyqësor të parashikuar në rastin e krimeve, si dhe pasojave që krijojnë në shmangien nga vlerësimi i përgjegjësisë penale të personit të dyshuar për kryerjen e veprës penale, për më tepër që vijnë pas dy vendimeve të gjykatave që janë shprehur për faktin e juridiksionit të tyre për këtë vepër penale në rastin e procedimit penal nr. 24/2018, si dhe pas vënies në dukje me procesverbal dhe nëpërmjet udhëzimit jo të detyrueshëm nga ana e drejtuesit të Prokurorisë. Për procedimet penale të viteve 2020 dhe 2021, veprimet e

prokurorit përbëjnë shkelje në të njëjtat konsiderata si edhe për procedimet penale të vitit 2018, por referuar ligjit 96/2016, parashikohen si të tilla në nenin 102, pika 1, germat "ç" dhe "dh".

10.4.2 Nuk ka marrë pjesë në seancat gjyqësore dhe është bërë shkak për shtyrje të tyre, mospjesëmarrje e cila rezulton të ketë qenë e vullnetshme, duke pasur dijeni për zhvillimin e seancave. Veprimet dhe mosveprimet e prokurorit Shkëlqim Kokona vlerësohen si shkelje e rëndë profesionale dhe etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës: sipas parashikimeve të nenit 148/d, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës, për procedimin penal të vitit 2018 për çështjen në ngarkim të të pandehurit A. K.; sipas parashikimeve të nenit 102, pika 1, shkronja "ç/ii", pika 2, shkronja "dh" e ligjit 96/2016, për çështjen në ngarkim të të pandehurit R. A.; sipas parashikimeve të nenit 102, pika 1, shkronja "ç" e ligjit 96/2016 për çështjen në ngarkim të të pandehurit O. V.; sipas parashikimeve të nenit 102, pika 1, shkronjat "dh" dhe "g" të ligjit 96/2016 lidhur me mosshpalljen e kompetencës lëndore në çështjen në ngarkim të të pandehurit E. K.. Për çështjen në ngarkim të të pandehurit G. M., e cila është në gjykim në Gjykatën e Apelit e, për rrjedhojë, i mbetet kësaj gjykate për të vlerësuar lidhur me akuzën, por nga të dhënat gjatë procedimit nuk konstatohet e provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm që prokurori zëvendësues Shkëlqim Kokona të ketë vepruar përtej bindjes së brendshme, të garantuar nga neni 3 i ligjit 96/2016, për të ndryshuar akuzën e ngritur nga prokurori i çështjes[14]. Sjellja e prokurorit në çështjen me të pandehur A. F., përbën shkelje, por referuar periudhës kur ka ndodhur, ka pasur vakum ligjor në ligjin nr. 96/2016 dhe referohet neni 148/d, pika 2, germa "a" e Kushtetutës. E marrë si sjellje më vete, në kushtet kur në përfundim çështja është pushuar nga ana e gjykatës, referuar faktit të mosprovueshmërisë së kryerjes së veprës penale, vlerësohet se nuk përbën shkelje të rëndë profesionale sipas parashikimit kushtetues.

10.4.3 Sjellja e prokurorit Shkëlqim Kokona për mosnxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit për vendimin penal nr. {***}, datë 16.12.2019, përbën mospërmbushje të pajustifikuar të funksionit të prokurorit që duhet të marrë masa për ekzekutimin e vendimeve penale, sipas parashikimeve të nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale dhe shkelje sipas nenit 102, pika 1, germa "ç" e ligjit 96/2016; dhe për vendimin nr. {***}, datë 09.01.2020, i cili lidhet me të drejtat dhe liritë e personit që, referuar parashikimit ligjor procedural dhe penal, përbën shkelje disiplinore sipas nenit 102, pika 1, germa "ç" e ligjit 96/2016.

10.4.4 Për periudhën 2019-2021, prokurori Shkëlqim Kokona nuk ka nxjerrë urdhra për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të dënimit me burgim, për të cilat është aplikuar pezullimi i ekzekutimit me kusht, sipas nenit 59 të K.Penal, veprim që rezulton i provuar në 28 raste për të cilat urdhrat e ekzekutimit janë nxjerrë nga drejtuesi i Prokurorisë, sipas kohës apo nga një prokuror tjetër. Referuar urdhrit nr. 3, datë 20.03.2018, të drejtuesit të Prokurorisë lidhur me organizimin e procedurave të ekzekutimit, nxjerrë në bazë dhe për zbatim të ligjit për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë, parashikohet se prokurore e ekzekutimeve është D. B., e cila nxjerr urdhrat e ekzekutimit të vendimeve penale, përveç urdhrave që u përkasin dhe nxirren posaçërisht nga prokurorët e seancës së parashikuar. Në rastet e evidentuara, ka qenë detyrim i prokurorit Shkëlqim Kokona të nxirrte urdhrin e ekzekutimit, i cili, me vullnetin e tij, nuk i ka

[14] Në aspektin formal procedural, nga procesverbalet e seancave gjyqësore, rezulton se ndërhyrja e prokurorit për ndryshimin e akuzës, është bërë pas pyetjes së një dëshmitareje, e cila nuk ishte pyetur nga prokurori i çështjes S. K., dhe në vazhdim ka vijuar normalisht me dhënien e kohës së mjaftueshme të pandehurit për t'u njohur me ndryshimin e akuzës.

nxjerrë këta urdhra, duke kryer shkeljen e mospërmbushjes së funksionit të prokurorit në mënyrë të pajustifikuar dhe të përsëritur, të parashikuar në nenin 102, pika 1, germa "ç" e ligjit 96/2016.

10.4.5 Nga ana e prokurorit Shkëlqim Kokona, ka pasur shkelje të përsëritur dhe të rëndë të normave të sjelljes dhe solemnitetit, rregullave të mirësjelljes në marrëdhëniet me drejtuesit e prokurorisë, me oficerët e policisë gjyqësore, me gjyqtarët dhe mbrojtësit e të pandehurve, me personelin e administratës së prokurorisë, me personelin e gjykatës, ku qëndrimi i prokurorit me shkelje të solemnitetit, përdorim të fjalëve fyese dhe shprehjeve që kalojnë nivelin e komunikimit normal jo vetëm në aspektin profesional, por edhe atë njerëzor, përshkruhet i plotë në paragrafët përkatës të vendimit. Referuar parashikimit të nenit 4 të ligjit 96/2016, si dhe rregullave të etikës të parashikuara në urdhrin nr. 141, datë 19.06.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, në fuqi edhe aktualisht, sjellja e prokurorit Shkëlqim Kokona vjen në shkelje të rëndë dhe të përsëritur të normave të sjelljes dhe solemnitetit të gjykimit.

10.5 *Lidhur me pretendimin se KLP-ja nuk ka çmuar saktë veprimtarinë administrative të ILD-së*

10.5.1 *Lidhur me vendimin e ILD-së për shtimin e objektit të hetimit,* KLP-ja prapëson se nuk mund të ndërhyjë në kompetencat e ILD-së, kur ligji shprehet qartë se i takon këtij të fundit të vendosë për shtimin e objektit të hetimit disiplinor, kur plotësohen kërkesat e ligjit. ILD-ja, sipas kompetencës së përcaktuar në nenin 125 të ligjit 96/2016, ka vendosur për shtimin e objektit të hetimit disiplinor, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 148/d, pika 2, germa "a" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, germat "ç", "d", "dh", "g", dhe pika 2, germat "a" dhe "dh" të ligjit 96/2016, dhe e ka njoftuar këtë vendim si për magjistratin, ashtu edhe për KLP-në, me shkresën nr. {***}, datë 30.07.2021.

10.5.2 *Lidhur me pretendimin se KLP-ja duhet të kishte disponuar me pushimin e kërkesës, pasi në seancë dëgjimore nuk është paraqitur Inspektori i Lartë i Drejtësisë, por inspektorët e autorizuar prej tij*

10.5.2.1 ILD-ja, me shkresën nr.{***}, datë 13.12.2021, ka shprehur vullnetin, duke autorizuar inspektorët përkatës të kryejnë të gjitha veprimet në emër të institucionit, përfaqësim që vjen në përputhje me parashikimet e nenit 34 të ligjit 44/2015 dhe nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile. Ligji 96/2016 dhe ligji 115/2016, në asnjë rast nuk përmend që Inspektori i Lartë i Drejtësisë duhet të paraqitet personalisht në seancë dëgjimore. Në të kundërt, neni 214 i ligjit 115/2016 përcakton se: *Inspektorët i ushtrojnë detyrat e tyre në emër të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.* Me termin "Inspektori i Lartë i Drejtësisë", ligji i referohet organit/institucionit që drejtohet nga inspektori, i cili me vullnetin e tij mund të delegojë përfaqësimin te nëpunësit e tij, pasi ka tagrat për të deleguar përfaqësimin, sipas ligjit Në të gjitha kontekstet, autorizimi i ILD-së për përfaqësim është në përputhje me kërkesat ligjore, dhe legjitimimi i të autorizuarve nga ana e KLP-së, si palë e interesuar në seancën dëgjimore, është tërësisht i bazuar në ligj.

10.5.3 *Lidhur me pretendimin se KLP-ja nuk ka analizuar afatet e procedurave të ndjekura nga ILD-ja.* Bazuar në parashikimet e nenit 118 të ligjit 96/2016, KLP-ja prapëson se afati i hetimit është zgjatur si pasojë e informacionit të përcjellë nga Prokurori i Përgjithshëm, për të cilin ka arsye të përligjura për zgjatjen e afatit, pasi konstatoheshin shkelje të tjera disiplinore nga ana e magjistratit, dhe se nuk rezulton që magjistrati t'i jetë drejtuar me ankesë KLP-së lidhur me moszbatimin e afateve të hetimit, sipas parashikimeve të nenit 118, pika 5 e ligjit 96/2016.

10.6 *Lidhur me pretendimin se vendimi i KLP-së nuk pasqyron asnjë pohim/provë të magjistratit dhe qëndrimet ligjore janë pasqyruar pjesërisht në vendim,* KLP-ja prapëson si vijon.

10.6.1 Magjistrati ka ushtruar të drejtën e tij për të dorëzuar prova të reja, të cilat janë evidentuar qartazi në vendim. Sikundër evidentohet në paragrafin 3.4.3 të vendimit, KLP-ja vendosi të pranojë kërkesën e tij për të paraqitur prova të reja, me argumentin se për administrimin ose jo të tyre, do të shprehej në përfundim të seancës. Nuk është pranuar si provë ligji nr. 8577/2000, si fakt i njohur publik, i disponuar prej KLP-së. Provat e pranuara, evidentuar në paragrafin 3.9 të vendimit, janë depozituar në zyrën e protokollit, pa inventar, me nr. {***} prot., datë 13.12.2021. Lidhur me pretendimin *se magjistrati ka depozituar një numër të konsiderueshëm vendimesh* dhe se *KLP-ja nuk ka mbajtur qëndrim rast pas rasti për secilin nga momentet e pretenduara si shkelje disiplinore,* rezulton i pavërtetë duke referuar si në regjistrimin audio të seancës, ashtu edhe në vendimin e arsyetuar të KLP-së. Dokumentet që janë depozituar prej magjistratit në zyrën e protokollit pas seancës dëgjimore, dhe për të cilat KLP-ja nuk është shprehur mbi pranueshmërinë e tyre, nuk mund të pranoheshin në cilësinë e provës.

10.6.2 Për pohimet që magjistrati ka bërë në seancë dëgjimore, i gjithë qëndrimi i tij është reflektuar në vendimin objekt ankimi, faqet 76 -77 të tij, duke mos përfshirë fraza, si: "do të bëj kallëzim penal", "mbylle, mbylle" etj., të konsideruara të panevojshme për t'u trajtuar në arsyetimin e vendimit. KLP-ja ka marrë parasysh, duke e çmuar të nevojshëm, të gjithë qëndrimin e magjistratit, bazuar në nenet 214, 281 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, nenit 41 të ligjit për gjykatat administrative dhe nenit 100 të ligjit 44/2015, duke reflektuar pretendimin e tij sipas kërkesave ligjore në vendimin e arsyetuar.

10.6.3 *Lidhur me pretendimin se KLP-ja nuk ka mbajtur qëndrim për secilën nga provat e kontestuara gjatë seancës dëgjimore dhe të nxirrte përfundime mbi pranueshmërinë e tyre, për rrjedhojë vendimi është absolutisht i pavlefshëm,* KLP-ja prapëson se qëndrimi ka qenë i qartë ndaj provave që subjekti i procedimit disiplinor ka vendosur të depozitojë në seancë. Për ankimin e magjistratit drejtuar Gjykatës Kushtetuese, me objekt: *Shfuqizimin si antikushtetues për vendimin për hetimin disiplinor [...],* si pasojë e të cilit, në kërkesat paraprake, subjekti ka kërkuar pezullimin e procedimit, KLP-ja ka vendosur rrëzimin e kërkesës, pasi i vetmi institucion kompetent për shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve të ILD-së, është KLP-ja. KLP-ja u shpreh se nuk ndodhej në asnjë nga kushtet e pezullimit të parashikuara nga neni 145, që referon në nenin 126 të ligjit 96/2016. Analizat vjetore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec dhe dëftesa e komunikimit me nr. akti {***} e Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, në bazë të nenit 29 të Kodit të Procedurës Civile, janë çmuar sipas rëndësisë së tyre në marrjen e vendimit. Analizat vjetore të punës janë të njohura nga palët, pasi janë marrë në konsideratë në fazën e hetimit disiplinor dhe sipas parashikimit të nenit 80 të ligjit 44/2015, konsiderohen fakte të njohura për KLP-në. Sa më sipër, KLP-ja ka zbatuar me përpikëri procedurën ligjore për paraqitjen e provave nga ana e subjektit, duke u shprehur mbi pranueshmërinë e tyre në seancë dëgjimore, ka dhënë shpjegime të përmbledhura të vlerësimit të tyre në arsyetimin e vendimit, për rrjedhojë pretendimi se vendimi objekt ankimi është absolutisht i pavlefshëm për shkak të mosmbajtjes qëndrim për secilën provë, nuk qëndron dhe nuk duhet të merret parasysh nga Kolegji.

10.7 *Lidhur me pretendimin se është e pamundur që vendimmarrja e KLP-së të jetë e kundërt me atë të ILD-së, duke qenë se anëtarët e KLP-së janë subjekte hetimi nga ILD-ja,* KLP-ja prapëson se është tërësisht i pambështetur në ligj e në prova, se është tendencioz për shkak të përsëritjes në

mënyrë të shpeshtë në ankim, pa sqaruar ku mbështetet dhe ku provohet me fakte që ka ndodhur diçka e tillë, dhe se mungojnë argumentet për të provuar se KLP-ja, si organ *quasi gjyqësor,* nuk ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme apo anëtarët e KLP-së kanë pasur interesa personalë në këtë çështje. Pavarësia në vendimmarrje e KLP-së garantohet nga Kushtetuta dhe aktet ligjore, anëtari i KLP-së është bartës i një funksioni shtetëror dhe i përgjigjet dhe i shërben vetëm ligjit[15]. Në të kundërt me sa pretendon magjistrati, nga praktika e nisur në fushën e procedimeve disiplinore, dëshmohen disa vendimmarrje të KLP-së të kundërta me propozimin e ILD-së.

10.8 *Lidhur me pretendimin se për shkeljet e pretenduara ka kaluar afati 6-mujor nga koha e konstatimit të tyre e, për rrjedhojë, janë parashkruar,* KLP-ja prapëson se në referim të parashikimeve të nenit 117 të ligjit 96/2016, rezulton që në këtë procedim disiplinor, për veprimtarinë e prokurorit për periudhën 2018 - 2021, për asnjë nga faktet nuk ka kaluar afati 5-vjeçar i parashkrimit në kohën kur ka filluar hetimi disiplinor.

11 Në përfundim të prapësimeve, KLP-ja kërkon rrëzimin e ankimit të kërkuesit Shkëlqim Kokona si të pabazuar në prova e në ligj dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 411, datë 17.12.2021.

12 ***Parashtrimet e ILD-së, lidhur me shkaqet e paraqitura nga magjistrati Shkëlqim Kokona***

12.1 *Lidhur me pretendimet për cenimin e parimit kushtetues të procesit të rregullt ligjor dhe të neneve 6 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.* Për të garantuar pavarësinë dhe palëvizshmërisë nga detyra të magjistratit, por edhe për ruajtjen e autoritetit dhe besimit të publikut te ky funksionar, nëpërmjet ndryshimeve kushtetuese të miratuara në kuadër të reformës në drejtësi, rastet e shkarkimit apo pezullimit nga detyra të magjistratit u parashikuan në dispozita kushtetuese, përkatësisht në nenet 140 dhe 148/d të saj. Shkarkimi nga detyra është sanksioni më i rëndë disiplinor dhe për këtë shkak legjislatori e ka parashikuar dhe e ka ngritur atë në nivel kushtetues, neni 140, pika 2, shkronja "a" dhe neni 148/d, pika 2, shkronja "a", me qëllim që të ofrojë garancitë e nevojshme për palëvizshmërinë dhe pavarësinë në ushtrimin e detyrës së magjistratit. Nga ana tjetër, ligji 96/2016 parashikon në mënyrë të detajuar parimet mbi të cilat zhvillohet hetimi disiplinor, procedurën e hetimit, të drejtat dhe detyrimet e palëve të përfshira në këtë proces. Referuar ligjit në fuqi gjatë kohës së kryerjes së veprimtarisë hetimore lidhur me: marrjen e vendimeve për pushimin e procedimeve penale nr. {***} dhe nr. {***}, në kundërshtim me ligjin procedural penal; mosveprimin e prokurorit lidhur me procedimin penal nr. {***}, datë 24.02.2019; mospjesëmarrjen pa shkaqe të arsyeshme në seancën gjyqësore me objekt shuarjen e masës së sigurimit në datën 22.11.2018 dhe në seancën gjyqësore të gjykimit të themelit të çështjes në datë 26.11.2018; për çështjen me të pandehur shtetasin A. K., duke shkaktuar zvarritje të gjykimit, për të cilat nga hetimi dhe procedimi disiplinor rezulton e provuar se nga ana e ankuesit janë kryer shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 148/d, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës, nuk mund të nënkuptojë kurrsesi që magjistrati të mos përgjigjet disiplinarisht për shkak të vakumit të përkohshëm ligjor të krijuar nga vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese. Shkeljet e sipërcituara gjatë periudhës së vakumit ligjor u vlerësuan bazuar në kriteret e parashikuara në nenin 148/d, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës, por në raport edhe me shkeljet e tjera objekt i këtij hetimi dhe procedimit disiplinor, të cilat shtrihen në periudhën 2019 – 2021 të veprimtarisë së ankuesit, si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec. Ekzistenca e vakumit të përkohshëm ligjor të shkaktuar nga vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese, nuk mund të interpretohet kurrsesi si cenim i parimit të procesit të rregullt ligjor, të konsiderohet si shkak i

[15] *Referojuni vendimeve të Gjykatës Kushtetuese: nr. 1, datë 26.01.2021; nr. 34, datë 10.04.2017.*

shmangies nga përgjegjësia disiplinore, apo të mund të përdoret nga magjistrati si shkak për të mos përmbushur funksionin e tij në mënyrë të rregullt ose për të kryer shkelje profesionale të natyrës që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës. Çdo vlerësim i ndryshëm do të cenonte jo vetëm sistemin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së magjistratëve, por do të përbënte edhe precedent të rrezikshëm, duke ndikuar drejtpërdrejt në cenimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

12.2 *Lidhur me pretendimet për cenimin e parimit të procesit të rregullt ligjor gjatë hetimit disiplinor*, ILD-ja parashtron se gjatë procesit të hetimit disiplinor, por edhe gjatë zhvillimit të procedimit disiplinor në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, magjistratit i janë siguruar të gjitha të drejtat dhe garancitë e parashikuara nga neni 42, pika 2 e Kushtetutës, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe ato të parashikuara nga ligji 96/2016 dhe në këtë këndvështrim, parimi i procesit të rregullt ligjor rezulton të jetë respektuar në të gjitha elementet e tij.

12.2.1 *Lidhur me pretendimin për cenim të së drejtës për t'u njohur me natyrën dhe shkakun e akuzës administrative*, bazuar në kërkesat e neneve 123, pika 3, shkronja "dh", 124 dhe 129 të ligjit 96/2016, si dhe të neneve 35, 42, 45, 78 të ligjit 44/2015, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 14.06.2021, magjistratit i është njoftuar vendimi nr. {***} prot., datë 11.06.2021, i ILD-së "Për fillimin e hetimit disiplinor" dhe i janë bërë me dije të drejtat dhe detyrimet[16]. Nga ana e magjistratit, rezulton se nuk janë parashtruar argumente apo prova në mbrojtje të interesave të tij në këtë procedurë hetimore administrative, por është paraqitur vetëm një kërkesë në të cilën shprehet se: *[…] Sa më sipër, kërkojmë të verifikohet ankesa nga ana juaj në mënyrë urgjente pasi ka sjellë pasoja të pariparueshme për hetimin dhe gjykimin e mëtejshëm të çështjes sime dhe personat përgjegjës të vihen para përgjegjësisë administrative dhe penale […]. Për këtë, duhet të pezulloni hetimin disiplinor derisa të përfundojnë gjykimi i padisë për shpifje dhe proceset hetimore në ngarkim të zotit E. K. etj., që janë në proces hetimi*. Bashkëlidhur kërkesës, magjistrati ka paraqitur padinë për shpifje të depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, drejtuar shtetasit B. Sh. në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, shtetases D. B. në cilësinë e prokurores pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, ndaj shtetases E. M. në cilësinë e gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe ndaj avokatit G. B., si të akuzuar për veprën penale të "Shpifjes" të kryer botërisht, parashikuar nga neni 120/2 i K.Penal, për të cilën nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë është dërguar informacioni se çështja është pushuar me vendimin nr. {***}, datë 22.09.2021[17]. Në raportin e hetimit disiplinor, në paragrafin 63.2 të tij, janë dhënë arsyet e mosmarrjes në konsideratë të kërkesës së magjistratit për pezullimin e hetimit disiplinor për shkak të mospërmbushjes së kritereve të parashikuara në nenin 126 të ligjit

[16] *Të drejtat dhe detyrimet, si : (i) të përfaqësohet vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi të zgjedhur sipas parashikimeve në Kodin e Procedurave Administrative; (ii) aksesi në dosjen e hetimit duke kërkuar edhe kopje të akteve të saj, në atë masë që është në përputhje me objektin e hetimit; (iii) të dorëzojë parashtresë dhe dokumente mbështetëse brenda tri javëve nga marrja e vendimit të fillimit të hetimit disiplinor; (iv) të kërkojë dakordësi mbi marrëveshjen e përbashkët të pranimit lidhur me shkeljen disiplinore që i atribuohet; (v) të drejtën të njoftohet për çdo vendim që do të merret gjatë hetimit disiplinor; (vi) të ushtrojë të drejtën e ankimit ndaj atyre vendimeve.*

[17] *Shih shkresat nr. {***} prot., datë 15.07.2021, nr. {***} prot., datë 29.07.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, regjistruar në ILD me nr. {***} prot., datë 19.07.2021 dhe me nr. {***} prot., datë 02.08.2021; shih shkresën me nr. {***} prot., datë 01.09.2021, e regjistruar në ILD me nr. {***} prot., datë 03.09.2021, me të cilat paraqitet informacioni i shoqëruar me akte, sipas të cilit pranë kësaj gjykate figuron e regjistruar çështja penale me nr. regjistri themeltar {***} datë regjistrimi 29.06.2021, pushuar me vendimin nr. {***}, datë 22.09.2021.*

96/2016[18]. Për sa rezulton e provuar se gjatë procedurës së hetimit disiplinor i është garantuar e drejta për t'u njohur me hetimin disiplinor që po zhvillohej ndaj tij, si dhe e drejta për t'u mbrojtur dhe paraqitur parashtrime në përputhje me afatet ligjore, mosveprimi i magjistratit nuk mund të interpretohet kurrsesi si cenim i elementeve të një procesi të rregullt ligjor.

12.2.2 Magjistrati rezulton të jetë njoftuar edhe në lidhje me vendimmarrjen nr. {***}, datë 30.07.2021, "Për shtimin e objektit të hetimit", vendim i cili i është përcjellë së bashku me aktin e njoftimit të të drejtave në adresën e ushtrimit të funksionit të magjistratit, nëpërmjet shkresës nr. {***}, datë 30.07.2021, dhe nr. {***}, datë 30.07.2021. Sipas korrespondencës me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, këto shkresa rezultojnë të regjistruara pranë këtij institucioni, por nuk janë pranuar të merren në dorëzim nga ana e ankuesit[19]. Edhe në këtë rast, nga ILD-ja janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme procedurale në funksion të materializimit të së drejtës së subjektit të hetimit disiplinor për t'u njohur me objektin e hetimit, për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur argumentet e tij në përputhje me afatet ligjore, si pjesë e procesit të rregullt ligjor. Refuzimi i magjistratit për t'u informuar mbi akte të lidhura me hetimin disiplinor të nisur ndaj tij, sikundër vendimi për shtimin e objektit të hetimit disiplinor, nuk mund të argumentohet kurrsesi si cenim i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i cili është respektuar në të gjithë komponentët e tij gjatë hetimit dhe procedimit disiplinor.

12.2.3 *Lidhur me pretendimin për cenim të së drejtës për t'u mbrojtur me avokat,* ILD-ja parashtron se gjatë fazës së hetimit disiplinor, magjistrati nuk është shprehur se kërkonte mbrojtjen e interesave të tij nëpërmjet një avokati duke njoftuar dhe të dhënat e tij me qëllim komunikimin e akteve. Fakti që ankuesi nuk ka zgjedhur dhe nuk ka njoftuar zgjedhjen e mbrojtësit gjatë procedurës hetimore nuk mund të interpretohet në asnjë rast si mohim i së drejtës për t'u mbrojtur.

12.2.4 *Lidhur me pretendimin për mosrespektim të afateve ligjore në fillimin e hetimit disiplinor*, ILD-ja parashtron se afati 3-mujor i parashikuar në nenin 118 nuk ka karakterin e një afati prekluziv, por është një afat i vendosur në dispozicion të organit të hetimit disiplinor për të marrë një vendim për arkivim të ankesës apo fillimin e hetimit disiplinor. Në rastin e këtij hetimi disiplinor, i janë nënshtruar verifikimit disa ankesa, duke konsideruar që kërkesa e fundit është regjistruar me nr. {***} prot., datë 08.03.2021, ndërsa hetimi disiplinor ndaj ankuesit është filluar më datë 11.06.2021. Hetimi disiplinor është zhvilluar në përputhje me nenin 118 të ligjit 96/2016, respektivisht paragrafët 2 dhe 3 të tij që parashikojnë si afat për realizimin e hetimit disiplinor dhe paraqitjen e raportit të hetimit afatin 6-mujor nga dita e marrjes së vendimit për fillimin e hetimit.

12.2.5 *Lidhur me pretendimin për mungesën e legjitimitetit të inspektorëve për të përfaqësuar kërkuesin,* në procedimin disiplinor të zhvilluar përpara KLP-së, ILD-ja e vlerëson tërësisht të

---

[18] Padia penale e prokurorit orientohet në drejtim të faktit se nga ana e të akuzuarve, ku përfshihet edhe prokurore D.B., në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë përgatitur dokumentacion të falsifikuar dhe se kanë shpifur ndaj atij, duke përhapur thënie dhe dhënë informacione, duke e ditur se janë të rreme, por pa u ndalur konkretisht në përmbajtjen e tij se cilat janë këto informacione, memo apo shkresa zyrtare që të ishte e mundur për të kuptuar se bëhej fjalë për të njëjtat fakte të cilat janë konsideruar se përbëjnë shkelje disiplinore. Të ndodhur në këto rrethana dhe duke pasur parasysh se për këtë çështje penale në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, nuk është mbajtur asnjë seancë gjyqësore ku prokurori Shkëlqim Kokona të paraqitej dhe të shpjegonte konkretisht faktet objekt padie penale, nuk mund të konkludohet se jemi në kushtet për t'u vlerësuar pezullimi i hetimit disiplinor referuar parashikimeve të nenit 126 të ligjit nr. 96/2016.

*[19] Shkresa me nr. {***} prot., datë 17.09.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.*

pambështetur, në referim të parashikimeve të nenit 38 të ligjit 44/2015[20]. Gjithashtu vlerëson se legjitimiteti i inspektorëve për të përfaqësuar ILD-në gjatë procedimit disiplinor, është verifikuar nga KLP-ja si një detyrim i parashikuar në nenin 30 të rregullores "Mbi funksionimin e Komitetit Disiplinor për zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve"[21], pas hapjes së seancës dëgjimore.

12.3 *Lidhur me pretendimin se shkeljet e rënda profesionale janë fiktive dhe të rreme*, ILD-ja parashtron se gjatë hetimit disiplinor dhe procedimit disiplinor u provua se nga ankuesi Shkëlqim Kokona, gjatë ushtrimit të funksionit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, për periudhën hetimore 2018 – 2021, janë kryer veprime/mosveprime dhe janë shfaqur sjelljet, që përbëjnë shkelje të rënda profesionale dhe etikeqë diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës. Në këndvështrim të analizës së elementeve të referuar në vendimin nr. 75/2002 të Gjykatës Kushtetuese[22], në raport me sjelljen e prokurorit Shkëlqim Kokona, ILD-së i rezulton se:

12.3.1 Për sa i takon elementit të rrethanave të kryerjes së tyre, gjatë hetimit disiplinor rezultoi e provuar se magjistrati Shkëlqim Kokona:

- Në kundërshtim me nenet 24 dhe 25, 304 e vijues të KPrP, nenin 3 të ligjit nr. 96/2016, nenet 4, 5, 6 dhe 11 të ligjit nr. 97/2016, ka refuzuar marrjen në dorëzim të dosjeve të ardhura nga ish-Prokuroria për Krime të Rënda dhe të shortuara më datë 06.01.2020; ka refuzuar ushtrimin e ndjekjes penale të dy kallëzimeve me nr. {***} dhe {***}, si dhe ka refuzuar marrjen në dorëzim të dosjeve të prokurorit S. K. për shkak të largimit të tij, të shortuara sipas shortit të datës 09.06.2020.
- Nuk ka përmbushur funksionin e tij për përfaqësimin në gjyq të çështjeve pa shkaqe të arsyeshme duke u bërë shkak për shtyrje të tyre, përkatësisht nuk ka marrë pjesë dhe është bërë shkak për shtyrje, në seancat gjyqësore për gjykimin e të pandehurit A.K., për shqyrtimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit të shtetasit R. A, dhe të gjykimit të të pandehurit O. V.; mosparaqitje për shkaqe të paarsyeshme në seancat e datave 03.01.2021 dhe 04.01.2021 për gjykimin e çështjes me objekt "zbatimin e masës së sigurimit" ndaj të pandehurit E. K.
- Nëpërmjet mosveprimit të tij lidhur me procedimin penal nr. {***}, datë 24.02.2019, ka shkaktuar zvarritje në kryerjen e veprimeve hetimore për rreth 3 muaj.
- Ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e neneve 328 dhe 329/a të KPrP në marrjen e vendimeve për pushimin të çështjeve nr. {***} të vitit 2018, nr. {***} të vitit 2018, nr. {***}, datë 17.02.2021, nr. {***}, datë 17.10.2020, nr. {***}, datë 09.01.2021 dhe nr. {***}, duke mos marrë parasysh udhëzimet përkatëse jodetyruese për çështje konkrete të nxjerra nga ana e drejtuesit të Prokurorisë për mbarëvajtjen e eficencës së hetimit të çështjes.

---

[20] Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 38, parashikon të drejtën e palëve në një procedurë administrative për të zgjedhur përfaqësues, me qëllim kryerjen e disa ose të gjitha veprimeve procedurale gjatë kësaj procedure.

*[21] Miratuar me vendimin nr. {***}, datë 17.11.2020, të KLP-së.*

[22] Gjykata Kushtetuese, në vendimin 75/2022 arsyeton se: "Shprehja "akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën [...]", parashikuar nga nenet 128, 140 dhe 149, pika 2 e Kushtetutës, përmbledh në vetvete një sërë elementesh, të cilat mund dhe duhet të identifikohen rast pas rasti nga organi përkatës që merr vendimin për shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe Prokurorit të Përgjithshëm. Ato janë të lidhura me aktet dhe sjelljet e parregullta e të padenja që këta funksionarë të lartë kryejnë gjatë ushtrimit të detyrës, për shkak të saj, por edhe jashtë detyrës. Këto veprime apo mosveprime që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momentit subjektiv, si dhe nga dëmet që ato i sjellin shoqërisë e shtetit, janë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese nga këto subjekte".

- Nuk ka respektuar udhëzimin e detyrueshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr. {***}, datë 10.12.2019, i nxjerrë për marrjen e masave administrative dhe procedurale me rastin e fillimit të funksionimit të Prokurorisë së Posaçme, jo vetëm nëpërmjet mosshpalljes së moskompetencës dhe dërgimit të akteve prokurorisë kompetente, por edhe duke vepruar me kryerjen e veprimeve hetimore.
- Në shkelje të detyrimit për përmbushjen e funksioneve, nuk ka nxjerrë urdhrat e ekzekutimit për vendimin penal nr. {***}, datë 16.12.2019, me të pandehurin M.M; urdhrin e ekzekutimit të masës mjekësore, mjekim i detyruar ambulator i vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me nr. {***}, datë 09.01.2020, për shtetasin N.T.; gjatë periudhës 2019 – 2021, nuk ka nxjerrë urdhrat për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të dënimit me burgim, për të cilat është aplikuar pezullimi i ekzekutimit me kusht, sipas nenit 59 të Kodit Penal, të cilat kanë sjellë si pasojë edhe vonesa në nxjerrjen e këtyre urdhrave nga drejtuesi i Prokurorisë apo prokuror tjetër për disa raste dhe, për rrjedhojë, cenim të të drejtave dhe lirive të personit të gjykuar.
- Në marrjen e vendimeve në kundërshtim me ligjin, në mënyrë të vetëdijshme për veprimin e kryer, duke u shkaktuar dëm viktimave në këto çështje, të cilave nuk u garantohet zbatimi i një procedure të ligjshme për të vënë para përgjegjësisë personat të cilët u kanë shkaktuar dëm.
- Ka shkelur në mënyrë të përsëritur dhe të rëndë të rregullat e solemnitetit, rregullat e mirësjelljes në marrëdhëniet me palët, me drejtuesit e prokurorisë, me gjyqtarët, me oficerë të policisë gjyqësore, si dhe me personelin e administratës së prokurorisë dhe të gjykatës nëpërmjet përdorimit të fjalëve që cenojnë nderin dhe dinjitetin si personal, edhe profesional të eprorëve të tij, të subjekteve procedurale, oficerë të policisë gjyqësore, gjyqtarë, avokatë e të pandehur, dhe të punonjësve të administratës së prokurorisë dhe gjyqësore, të shoqëruar me përdorimin e toneve të larta të zërit, kryerjen e veprimeve të orientuara në drejtim të dhunës fizike ndaj drejtuesve të prokurorisë; cenimin e solemnitetit në gjykim; si dhe përsëritjen e vazhdueshme të tyre.

12.3.2 Për sa i takon momentit subjektiv, rezulton se nga magjistrati:
- Janë ndërmarrë veprimet/mosveprimet dhe sjellje të cilat përbëjnë mospërmbushje të detyrës së prokurorit, si dhe janë shfaqur sjellje joprofesionale e joetike gjatë ushtrimit të funksionit, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit, si dhe dëmtojnë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.
- Shkeljet e ankuesit të cilat janë kryer në mënyrë drejtpërdrejtë, të vazhduar, të vullnetshme, të pajustifikuar nuk janë të natyrës së gabimeve në interpretimin apo zbatimin e legjislacionit material dhe procedural, por janë kryer me dashje, duke synuar edhe ardhjen e pasojës.

12.3.3 Në lidhje me elementin e tretë, atë të pasojave që i shkaktohen shoqërisë, shkeljet disiplinore të kryera nga ankuesi kanë sjellë pasoja, jo vetëm në cenimin e imazhit të prokurorit dhe humbjen e besimit ndaj tij, por kanë cenuar edhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, nocion i përcaktuar në nenet 3 dhe 4 të ligjit 96/2016, ku parashikohet se sjellja e magjistratit është e lidhur me garantimin e ruajtjes e forcimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Referuar parimeve të Bangalores[23], cenimi edhe vetëm i parimeve të etikës, në marrëdhëniet e punës apo edhe jashtë saj, mund të përbëjë shkak për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

[23] *Standarde të sjelljes etike të gjyqtarëve janë shtjelluar shtrueshëm dhe vazhdojnë të shtjellohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (CCJE), si dhe organet e qeverisjes së gjyqësorit në shumicën e vendeve anëtare të Këshillit të Evropës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.*

12.4. Në përfundim, ILD-ja vlerëson se veprimet/mosveprimet e sjelljet e ndërmarra nga ana e magjistratit Shkëlqim Kokona, në tërësinë e tyre përbëjnë shkelje të rënda profesionale që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës, dhe të parashikuara si të tilla nga neni 148/d, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronja "b", nënpika "ii", neni 102, pika 1, shkronjat "ç", "d", "dh", "g" dhe neni 102, pika 2, shkronjat "a" dhe "dh" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përbëjnë "*Shkelje shumë të rëndë disiplinore"* dhe kërkon nga Kolegji rrëzimin e ankimit të ankuesit Shkëlqim Kokona dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 411, datë 17.12.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë "Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistratit Shkëlqim Kokona, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec".

II. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Për legjitimimin e ankuesit

13 Juridiksioni Disiplinor i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit është një juridiksion kushtetues, i cili do të shoqërojë veprimtarinë e tij gjatë mandatit 9- (nëntë) vjeçar, sipas parashikimeve të nenit 179, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili përcakton: *Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar, gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë Drejtësisë. Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.*

13.1 Në vijim të këtij parashikimi kushtetues, neni 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i përcakton Kolegjit të Posaçëm të Apelimit ndër të tjera bazën ligjore, mbi të cilën do të procedojë gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues që lidhet me Juridiksionin Disiplinor, konkretisht: *Kolegji i Apelimit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese" dhe legjislacionit që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë: [...] b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.*

13.2 Çështja e legjitimimit është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i" dhe pika 2 e Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

13.3 Ankimi kushtetues individual duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të

pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13.4 Në çështjen objekt shqyrtimi, lidhur me legjitimimin e ankuesit, Kolegji vlerëson se kërkuesi Shkëlqim Kokona legjitimohet *ratione personae*, pasi vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë të cilin ka ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, është marrë në kuadrin e një procedimi disiplinor ndaj tij dhe kërkuesi ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13.5 Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f" e Kushtetutës, konstatohet se neni 192, pika 1 e ligjit nr. 115/2016, parashikon se vendimet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për masat disiplinore ndaj prokurorëve ankimohen në Gjykatën Kushtetuese. Bazuar në nenin 179, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, juridiksionin disiplinor kundër vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, gjatë mandatit 9- (nëntë) vjeçar, e ushtron Kolegji i Posaçëm të Apelimit. Pra, ankuesi nuk ka mjet tjetër ligjor ankimi, përveç kërkesës drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

13.6 Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë që ankimohet, është i datës 17.12.2021, ndërsa kërkesa e ankuesit është protokolluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit më datë 04.02.2022, dhe është regjistruar pas plotësimit të dokumentacionit, në datën 16.02.2022, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b" e ligjit nr. 8577/2000.

13.7 Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae,* Kolegji çmon se pretendimet e ankuesit ndaj vendimit nr. 411, datë 17.02.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, janë pretendime që *prima facie* hyjnë në juridiksionin disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe do të shqyrtohen në vijim.

14 *Vlerësimi i Kolegjit mbi shkaqet e ankimit të magjistratit Shkëlqim Kokona, lidhur me cenimin e procesit të rregullt ligjor dhe parimin e sigurisë juridike*

14.1 Magjistrati Shkëlqim Kokona pretendon se vendimi i KLP-së nr. 411, datë 17.12.2021, është marrë në kundërshtim me ligjin procedural civil dhe administrativ dhe në kundërshtim me ligjin nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar.

14.1.1 Kolegji, pasi u njoh me këtë shkak ankimi, si dhe me parashtrimet e subjekteve të interesuara, e vlerëson të pabazuar pretendimin se seanca dëgjimore është zhvilluar në mungesë të përfaqësuesit të magjistratit, pavarësisht kërkesës së tij për të pasur mundësinë të mbrohet me avokat. Nga analiza e vendimit objekt ankimi, rezulton se KLP-ja ka përmbushur detyrimin e nenit 141, pika 2, shkronja "dh" e ligjit 96/2016, ku në njoftimin për fillimin e procedimit disiplinor, ka bërë të ditur edhe të drejtën e përfaqësimit me avokat[24]. Megjithëse i njoftuar nga KLP-ja për të drejtën e përfaqësimit, magjistrati nuk është paraqitur me përfaqësues në seancë, në kërkesat paraprake nuk është shprehur lidhur me përfaqësimin me avokat, për pyetjen e drejtuar në seancë:

*[24] Shkresa nr. {***} prot., datë 21.10.2021, "Njoftim për fillim procedimi disiplinor dhe njohje me të drejtat"; shkresa nr. {***} prot., datë 21.10.2021, me lëndë "Njoftim vendimi për caktimin e datës së seancës dëgjimore mbi procedimin disiplinor", ka njoftuar subjektin për datën dhe orën e seancës, vendin, si dhe të drejtën për të paraqitur parashtresë me shkrim të paktën një javë përpara datës së seancës [në adresë të KLP-së ose përmes postës elektronike].*

nëse ai e disponon në seancën dëgjimore për t'u përfaqësuar me avokat[25], magjistrati në përgjigje, është shprehur: *[...] nuk ka lidhje qëndrimi im, qëndrimi im i tanishëm është që kërkesa dhe vendimmarrja e ILD-së, gjithë akti është absolutisht i pavlefshëm, sepse atij nuk i është dhënë mundësia gjatë fazës së hetimit administrativ të kishte një avokat, prandaj ka kërkuar pavlefshmërinë e aktit [...]*. Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, dëshmohet pjesëmarrje aktive e magjistratit pa asnjë kërkesë lidhur me mbrojtjen me avokat dhe vetëm në përfundim të seancës dëgjimore, është shprehur: *[...] faleminderit z. Kryetar, kthehemi në pikën e parë, i gjithë procesi është nul sepse kërkoj asistencën e avokatit. I gjithë procesi është nul z. Kryetar, po nuk më siguruat avokat. Faleminderit*. Kërkesa e magjistratit për t'i siguruar avokat nuk është e bazuar në kuptim të nenit 36 të ligjit 44/2015, i cili parashikon detyrimin e organit procedues për të pezulluar procedurën dhe për t'i kërkuar organit kompetent caktimin e përfaqësuesit ligjor kur pala nuk ka zotësi të plotë ose ka zotësi të kufizuar për të vepruar. Për sa magjistrati ka zgjedhur të vetëpërfaqësohet në seancën dëgjimore, sipas parashikimeve të nenit 22 të Kodit të Procedurës Civile, që përcakton: *palët mund të mbrohen vetë, përveç rasteve kur përfaqësimi është i detyrueshëm*, dhe pikës 1 të nenit 35 të ligjit 44/2015 që përcakton se: *Pala mund t'i kryejë të gjitha veprimet procedurale personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit, në përputhje me parashikimet e këtij Kodi,* dhe prej tij nuk është kryer asnjë veprim sipas parashikimeve të nenit 38 të po këtij ligji lidhur me përfaqësimin[26], deklarimi i tij në përfundim të seancës dëgjimore lidhur me përfaqësimin vlerësohet nga Kolegji si një përpjekje në funksion të zvarritjes së procedimit disiplinor të zhvilluar nga KLP-ja ndaj tij.

14.1.1.1 Magjistrati pretendon se edhe gjatë hetimit administrativ i është mohuar e drejta e këshilluesit "avokat", që sipas tij ka sjellë pasoja për efektivitetin e mbrojtjes në hetimin administrativ, pa referuar asnjë të dhënë për kohën dhe mënyrën se si është kërkuar prej tij në ILD përfaqësimi me avokat. Nga aktet në fashikuj, nuk rezulton që gjatë hetimit disiplinor, magjistrati të ketë kërkuar mbrojtjen e interesave të tij nëpërmjet një avokati, duke njoftuar dhe të dhënat e tij, me qëllim komunikimin e akteve. Në këtë situatë faktike, Kolegji vlerëson se pretendimi për mohim të së drejtës për t'u mbrojtur me avokat gjatë hetimit disiplinor në ILD, mbetet në nivel deklarativ dhe i paprovuar e, për rrjedhojë, i pabazuar.

14.1.2 Kolegji e vlerëson të pabazuar pretendimin se zhvillimi i seancës dëgjimore *on-line* është i paligjshëm, duke qenë se standardet e krijuara me aktin normativ nr. 9 të vitit 2020, nuk përbëjnë më një standard sigurie shëndetësore dhe ligji procedural nuk parashikon zhvillimin e procedurave dhe seancave *on-line*, por vetëm nëpërmjet ballafaqimit të palëve përpara gjykatës/organit publik. Referuar rregullores "Për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të administratës shtetërore gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19", miratuar më datë 23.10.2020, me urdhër nga Sekretari i Përgjithshëm i KLP-së, në nenin 6 të saj, "Minimizimi i riskut të infektimit nga Covid-19 gjatë mbledhjeve", përcaktohet se: *vetëm në rastin kur mbledhja nuk mund të zëvendësohet nga një video-konferencë mund të bëhet i mundur takimi*

[25] *Paragrafi 3.5, faqe 75, e vendimit të KLP-së.*

[26] *Kodi i Procedurave Administrative, në neni 38, "Përfaqësuesi i zgjedhur", parashikon: 1. Pala mund të zgjedhë një përfaqësues, me qëllim kryerjen e disa ose të gjitha veprimeve procedurale në procedurën administrative, përveç rastit kur kërkohet që vetë pala personalisht, të japë një deklaratë ose të kryejë një veprim tjetër procedural. 2. Zgjedhja e përfaqësuesit, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet në formë të shkruar, deklarohet verbalisht përpara organit publik dhe regjistrohet nga ky fundit ose në çdo formë tjetër të përshtatshme. 3. Zgjedhja e përfaqësuesit është e vlefshme nëse bëhet në formën e përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni [...].*

ballë për ballë, duke plotësuar kushtet e vendosura prej pandemisë, sikundër numri i reduktuar i pjesëmarrësve në mbledhje dhe distanca së paku dy metra larg njëri-tjetrit. Nga informacioni i marrë nga burime të hapura[27], rezulton se KLP-ja, përmes deklaratës publike të datës 19.11.2021, ka informuar se në respektim të masave për përballimin e situatës së krijuar nga pandemia, zhvillimi *on-line* përmes platformës *zoom* i seancave plenare, është ndjekur nga subjektet e interesuara, dhe *se prania fizike në ambientet ku zhvillohen seancat plenare do të jetë e kufizuar, për sa kohë ndodhemi në kushtet e pandemisë Covid-19.* Në këtë situatë faktike, akti i KLP-së, i bazuar në të drejtat dhe liritë themelore të sanksionuara në nenin 17 të Kushtetutës: *[…] Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë [...]. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave [...],* ka vendosur rregulla që japin garanci për pjesëmarrësit, me qëllim parandalimin e rrezikut dhe mënjanimin e pasojave të shkaktuara prej pandemisë, por pa cenuar të drejtën e subjektit të procedimit për t'u dëgjuar drejtpërdrejt nga KLP-ja, për rrjedhojë pa cenuar parimet e procesit të rregullt ligjor. Referuar numrit të pjesëmarrësve, zhvillimi i seancës dëgjimore *on-line* vjen në përputhje me parashikimet në aktin e sipërcituar, i cili rezulton të jetë zbatuar nga KLP-ja në veprimtarinë e saj gjatë kësaj periudhe, me qëllim parandalimin dhe mënjanimin e pasojave të ardhura prej pandemisë. Në respektim të garancive kushtetuese që nuk lejojnë që masat për shkak të gjendjes së shkaktuar nga pandemia të shmangin parimin e proporcionalitetit dhe të garancisë së thelbit, Kolegji vëren se magjistrati është njoftuar për zhvillimin e seancës dëgjimore *on-line* dhe nuk ka ngritur pretendime, po ashtu nga përmbajtja e vendimit objekt ankimi dhe nga regjistrimi audio i seancës dëgjimore, që nga nisja e saj, gjatë zhvillimit, si dhe në përfundim të seancës, konstatohet se nga ana e magjistratit nuk ka pasur asnjë shqetësim apo pretendim për cenim të së drejtës për t'u dëgjuar drejtpërdrejt nga organi procedues, KLP-ja. Për rrjedhojë, dëshmohet se zhvillimi i seancës dëgjimore *on-line* është gjetur i përshtatshëm edhe prej vetë magjistratit, sikundër parashikon pika 1 e nenit 88 të KPrA: *E drejta e palës për t'u dëgjuar ushtrohet në çdo formë të përshtatshme dhe brenda afatit të përcaktuar nga organi publik.*

14.1.2.1 Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka trajtuar të drejtën e pjesëmarrjes dhe të drejtën për t'u dëgjuar, si të drejta të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën[28]. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në një sërë vendimesh të saj, ka theksuar se: *Konventa nuk ka për qëllim të mbrojë të drejtat në mënyrë teorike dhe zhgënjyese, por të garantojë të drejta praktike dhe të efektshme, sidomos për sa i përket së drejtës për t'u paraqitur para një gjykate* dhe se e drejta e garantuar në nenin 6, pika 1 e KEDNj-së nënkupton medoemos të drejtën "për një dëgjesë publike"[29]. Lidhur me respektimin e kërkesave për "barazinë e armëve", si aspekt i procesit të rregullt, GjEDNj-ja shprehet *se: "barazi armësh" do të thotë që secilës palë duhet t'i sigurohen*

---

[27] https://klp.al/2021/11/19/njoftim-lidhur-me-akreditimin-për-ndjekjen-e-seancave-plenare-të-këshillit-të-lartë-të-prokurorisë/

[28] Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 12/2005, ku gjykata shprehet: "Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklarimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore"; nr. 8/2006, ku Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrim se: "Jurisprudenca kushtetuese dhe praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kanë përcaktuar standarde edhe për pjesëmarrjen në gjykim, me qëllim që t'i krijohen mundësitë secilës palë për të mbrojtur efektivisht të drejtën që pretendohet si e shkelur [...]. Pjesëmarrja e palëve në gjykim, dëgjimi i pretendimeve të tyre për provat e interpretimin e ligjit në çështjen konkrete, garantohet nga neni 42 i Kushtetutës e neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sepse kjo pjesëmarrje shërben për të mbrojtur në substancë të drejtat e secilës palë. Jo vetëm kaq, por krijimi i kushteve për të bërë një mbrojtje efektive është jo vetëm në interes të palëve, por edhe në interes të drejtësisë".

[29] Vendimi i GjEDNj-së, çështja Dory kundër Suedisë, paragrafi 37.

mundësitë përkatëse për t'i parashtruar çështjet e saj në kushte që nuk e venë atë në gjendje shumë më pak të favorshme se sa palën e kundërt"[30]. Referuar jurisprudencës së sipërcituar, e drejta për t'u dëgjuar nga gjykata është një element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, për faktin se shërben për të mbrojtur në substancë të drejtën që pretendohet si e shkelur, dhe lidhet kryesisht me të drejtën për të bërë kërkime/parashtrime dhe për të marrë përgjigje për to.

14.1.2.2 Nga shqyrtimi i vendimit objekt ankimi, si dhe regjistrimit audio të seancës dëgjimore, Kolegji konstaton se janë respektuar të gjithë rregullat procedurale: është verifikuar kuorumi dhe pjesëmarrja e anëtarëve, është kryer legjitimimi i palëve, nga ana e magjistratit janë paraqitur kërkesat paraprake dhe është disponuar lidhur me to, është kërkuar administrimi i provave të reja dhe KLP-ja ka disponuar lidhur me pranueshmërinë e tyre, janë parashtruar faktet nga relatori, magjistrati ka parashtruar prapësimet e tij, sikundër edhe pala e interesuar ILD-ja, dhe në fund është mbyllur seanca dëgjimore. Gjithashtu, edhe nga përmbajtja e ankimit, ku magjistrati shprehet se *[...] KLP-ja i ka dhënë të drejtën për të bërë pohime gjyqësore [...]*[31] *[...] ka parashtruar kërkesën për administrimin e provave*[32]*[...]*, Kolegji vëren se zhvillimi i seancës dëgjimore *on-line* ka krijuar të gjithë mundësitë dhe garancitë ligjore që ankuesi të parashtrojë çështjen e tij drejtpërdrejt përpara organit procedues, sikundër do t'i realizonte edhe në prezencë fizike.

14.2 Magjistrati pretendon se rezulton e provuar që pala kërkuese, ILD-ja, ka qenë në mungesë, në kuptim të nenit 204 të ligjit nr. 115/2016, pasi sipas tij, në asnjë rrethanë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk i lejohet delegimi i përfaqësimit te të tretët, dhe KLP-ja ka dështuar të verifikojë këtë detyrim ligjor. Kolegji, duke sjellë në vëmendje qëndrimin e mbajtur se nxjerrja e aktit të përfaqësimit është brenda tagrave që i njeh ligji drejtuesit të ILD-së[33], e vlerëson të pabazuar në ligj pretendimin se KLP-ja duhej të dispononte me pushimin e kërkesës për shkak të mosparaqitjes personalisht të palës që ka paraqitur kërkimin.

14.3 Magjistrati pretendon se procedura administrative e iniciuar nga ILD-ja është në kundërshtim me nenin 41 të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" që sanksionon se: *Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund cenohen nga veprimi administrativ, përveç kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor*, dhe bie ndesh haptazi me parashikimin në po të njëjtin nen se: *Organi publik është i detyruar të fillojë procedurën administrative kryesisht, kur a) ligji ose akti nënligjor parashikojnë fillimin e procedurës.*

14.3.1 Kolegji e vlerëson të pabazuar pretendimin se në vendimin objekt ankimi, nuk ka një analizë të afateve të ndjekura nga ILD-ja, për sa vendimi nr. {***} prot., datë 11.06.2021, që parashikon fillimin e hetimit disiplinor si rezultat të ankesave të datave 30.10.2020 dhe 13.01.2020, është marrë përtej afatit prekluziv ligjor të parashikuar në nenin 118, pika 1 e ligjit 96/2016[34]. Referuar vendimit të ILD-së nr. {***}, datë 30.04.2021, "Për bashkimin e ankesave ndaj magjistratit Shkëlqim Kokona [...]", rezulton se është disponuar për bashkimin e disa ankesave, ku ankesa e

---

[30] Vendimi i GjEDNj-së për çështjen Dombo Behere kundër Holandës, dhe Stratis Andreadhis kundër Greqisë V, 09.12.1994.
[31] Referoju faqes 12, paragrafit 3 të shtesës së ankimit.
[32] Referoju faqes 13, paragrafit 3 të shtesës së ankimit.
[33] Shih vendimin e Kolegjit nr. 1 (JD), datë 30.05.2022, paragrafi 11.6.
[34] Neni 118, "Afatet e procedimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë": "1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos të arkivojë ankesën ose të fillojë hetimin për shkeljen e pretenduar, brenda tre muajve nga marrja e ankesës".

fundit është regjistruar me nr. {***} prot., datë 08.03.2021, ndërkohë që hetimi disiplinor ndaj ankuesit ka filluar më datë 11.06.2021. Në situatën faktike kur organi procedues ka çmuar nevojën e trajtimit të të gjitha ankesave të regjistruara, Kolegji mban në konsideratë:
Së pari, nisur nga parimi i hetimit kryesisht sipas parashikimeve të nenit 77 të ligjit 44/2015[35], ILD-ja ka diskrecion të vendosë se çfarë është e nevojshme për t'u shqyrtuar në funksion të vlerësimit të fakteve dhe rrethanave që do t'i nënshtrohen hetimit disiplinor për zgjidhjen e çështjes. Në referim të datave të ankesave për të cilat ka filluar hetimi disiplinor, respektimi i afatit 3-mujor do të përjashtonte nga shqyrtimi ankesën e regjistruar më datë 08.03.2021, me pasojë të mundshme përsëritjen e procedurave që do të duhej të ndiqte ILD-ja, për rrjedhojë me ndikim në eficencën dhe efektivitetin e zhvillimit të procedimit administrativ.
Së dyti, neni 109, germa "b" e ligjit 44/2015[36] nuk bën dallim mbi dispozitat e detyrueshme për procedurën administrative, duke paraparë që në parim të gjitha rregullat e parashikuara kanë të njëjtën rëndësi. Humbja e afatit procedural 3-mujor të përcaktuar nga ligji për arkivimin e kërkesës apo fillimin e procedimit disiplinor, nuk ka sjellë pasojë në përkeqësimin e pozitës së magjistratit e, për rrjedhojë, të ketë cenuar të drejtat e tij të ligjshme dhe as të ketë ndikuar në rezultatin substancial të procedurës, prej tij nuk është ushtruar ankim ndaj këtij vendimi dhe në seancë dëgjimore nuk është pretenduar për ndonjë pasojë të ardhur. Nga ana tjetër, Kolegji evidenton se procedura administrative ka ndjekur kursin e saj normal dhe është përmbyllur me vendimmarrje të ILD-së në një afat më të shkurtër se afati i përcaktuar në ligj. Ligji 96/2016, në nenin 138, paragrafi 4, parashikon se: *Këshilli shqyrton të gjithë faktorët që kanë rëndësi për çështjen* dhe, në kuptim të kësaj dispozite, nuk merr relevancë shqyrtimi i humbjes së një afati ligjor për shkaqe objektive dhe pa pasoja për palën apo për zhvillimin e procedurës, përkundrejt faktit të përmbylljes së procedurës së hetimit disiplinor në një afat më të shkurtër se ai ligjor.

14.3.2 Kolegji e vlerëson të pabazuar pretendimin se KLP-ja nuk ka çmuar saktë veprimtarinë e ILD-së, parë nga perspektiva e procedurës së ndjekur për komunikimin e vendimit nr. 2709/23 prot., datë 30.07.2021, "Për shtimin e objektit të hetimit", pasi sipas tij nuk ka asnjë provë shkresore për të vërtetuar marrjen dijeni prej tij, me pasojë heqjen e mundësisë së tij për të kundërshtuar këtë vendim. Nga aktet në fashikuj, rezulton se vendimi i sipërcituar dhe akti i të drejtave që gëzon magjistrati, është përcjellë nga ILD-ja në adresën e ushtrimit të funksionit të magjistratit, konfirmuar dorëzimi i tyre nga dëftesa postare lajmërim-marrje. Nga informacioni që Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec ka dërguar, rezulton se shkresat janë regjistruar pranë këtij institucioni dhe më pas i janë dorëzuar prokurorit Shkëlqim Kokona, por prej tij nuk është pranuar të firmosej për marrjen në dorëzim të tyre[37]. Në këtë situatë faktike,

---

[35] Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 77, "Parimi i hetimit kryesisht", parashikon : "1. Organi publik heton kryesisht të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes. 2. Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin, qëllimin dhe shtrirjen e hetimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes".

[36] Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 109, "Paligjshmëria e aktit administrativ", në shkronjën "b" parashikon: "Një akt administrativ është i paligjshëm. [...] b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative [...]".

*[37] Shkresa nr. {***} prot., datë 17.09.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, nga përmbajtja e së cilës rezulton se shkresat e ILD-së, pas siglimit nga prokurori i gatshëm G. F., i janë përcjellë stafit të prokurorisë për të vijuar sipas procedurës, si dhe prej tij i është bërë njoftim prokurorit Shkëlqim Kokona përmes telefonit. Sipas procesverbalit të datës 14.08.2021, mbajtur nga punonjësja e Prokurorisë A. M., shkresat e ILD-së i janë dorëzuar prokurorit Shkëlqim Kokona, por prej tij nuk është pranuar të firmosej për marrjen në dorëzim të tyre, me pretendimin se do t'i lexonte njëherë. Në datë 10.09.2021, kryesekretarja ka komunikuar me prokurorin Shkëlqim Kokona për firmosjen e lidhur me marrjen e akteve, por prokurori nuk ka pranuar të firmosë, duke u shprehur se do*

rezulton se prokurori është njohur me vendimin e ILD-së për shtimin e objektit të hetimit, dhe mungesa e një prove shkresore për marrjen dijeni prej tij, vjen si pasojë e refuzimit të tij për të nënshkruar marrjen dijeni dhe, për këtë shkak, pretendimet e tij lidhur me procedurën e ndjekur nga ILD-ja, vlerësohen abuzive. Në këtë situatë faktike, e cila është e pasqyruar në vendimin objekt ankimi, Kolegji vlerëson se KLP-ja ka çmuar saktë veprimtarinë e ILD-së lidhur me komunikimin e vendimit nr. {***} prot., datë 30.07.2021, "Për shtimin e objektit të hetimit".

14.4 Magjistrati pretendon se antikushtetutshmëria e vendimit nr. 411, datë 17.12.2021, të KLP-së, rezulton mbi të gjitha pasi KLP-ja ka dështuar të identifikojë cilat janë veprimet apo mosveprimet e magjistratit në periudha të ndryshme dhe që bazuar në ligjin e kohës përbëjnë shkelje disiplinore të kryera prej tij. Nisur nga rrethanat e faktit, shfuqizimit nga Gjykata Kushtetuese me vendimin 34/2017, të dispozitave të ligjit 96/2016 që përcaktojnë ato që sipas ligjvënësit quhen shkelje disiplinore, dhe nga perspektiva e nenit 29 të Kushtetutës, asnjë person nuk mund të dënohet për një fakt i cili në kohën kur ka ndodhur, nuk përbënte shkelje apo fakt dënues.

14.4.1 Në lidhje me këtë pretendim, nga analiza e vendimit të KLP-së, rezulton e provuar se veprimet/mosveprimet e prokurorit të kryera në periudhën e vakumit të përkohshëm ligjor të krijuar nga vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese, përbëjnë shkelje sipas kritereve të nenit 148/d, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës, ku parashikohet se: *Prokurori shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës*. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka analizuar: *Këto shkelje marrin karakterin e rëndë të tyre lidhur ngushtë me rëndësinë e ligjit të shkelur, pasojat e ardhura ose që mund të vinin nga shkelja, frekuencën e shkeljes kohëvazhdimin e pasojave dhe të vështirësive për riparimin e tyre, si edhe qëndrimin subjektiv që mban autori i shkeljes kundrejt saj dhe pasojës së ardhur* [38]. Kushtetutshmëria e normës kushtetuese prezumohet në çdo rast, sepse të gjitha ligjet e tjera burojnë prej saj, dhe pa të nuk mund të ketë ligj autorizues, dhe në këtë kuptim nuk mund të pretendohet që vendimi objekt ankimi të jetë antikushtetues. Shkarkimi i prokurorit nga detyra është një sanksion kushtetues i posaçëm me natyrë disiplinore që lidhet me shkelje profesionale ose etike. Në vendimin e KLP-së, në asnjë moment nuk është referuar apo përmendur zbatimi i Kodit Penal apo Kodit të Procedurës Penale, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se referimi prej magjistratit i perspektivës së nenit 29 të Kushtetutës, është i pabazuar. Për sa më sipër, Kolegji mban në konsideratë edhe qëndrimin e mbajtur prej tij në çështjet e juridiksionit disiplinor se vendimi për dhënien e masës disiplinore ndaj magjistratit, i bazuar në nenin 148/d, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës, është në frymën e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 3, datë 20.02.2006[39].

14.5 Magjistrati pretendon se nga KLP-ja në vendimin nr. 411, datë 17.12.2021, janë aplikuar norma me frymë të përgjithshme kur në rastin konkret ligji i posaçëm përfshin aplikimin e normave specifike të posaçme, e kjo përbën cenim të sigurisë juridike për subjektin aktual të procedimit dhe

të bënte observacion të cilit do t'i bashkëngjiste aktet e firmosura prej tij dhe do t'i dorëzonte së bashku të hënën, më datë 13.09.2021[37]. Në komunikimin e kryesekretares më datë 13.09.2021, me prokurorin Shkëlqim Kokona, prej tij është mbajtur i njëjti qëndrim se do të bëjë observacion i tij duke bashkëlidhur të firmosura aktet e njoftimit, të cilin nuk e kishte ende gati.

[38] Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 75, datë 19.04.2002, qëndrim i rikonfirmuar në vendimin tjetër të saj nr. 1/2022, pika 138.

[39] Shih vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 1 (JD), datë 30.05.2022.

për të gjitha subjektet e ardhshme të një hetimi të iniciuar nga ILD-ja. Sipas magjistratit, fakti që ligjvënësi nuk ka marrë masa për të azhurnuar në përputhje me standardet e krijuara nga Gjykata Kushtetuese normat e shfuqizuara, nuk mund të përbëjë motiv diskriminimi për subjektin e procedimit disiplinor, nuk mund të krijojë premisa për organin që ka iniciuar hetimin që në mënyrë abuzive të fillojë hetime për shkelje disiplinore, të cilat pretendohen të kryera në kohën kur nuk parashikoheshin të tilla nga ligji i posaçëm.

14.5.1 Në konsideratë të qëndrimit të mbajtur[40], Kolegji vlerëson të pabazuar pretendimin për cenim të parimit të sigurisë juridike si pasojë e aplikimit të normave me frymë të përgjithshme, pasi rastet e shkarkimit të prokurorit janë të parashikuara nga neni 148/d, pika 2 e Kushtetutës, dhe zbatimi i drejtpërdrejtë i tij siguron që veprimet apo mosveprimet e prokurorit që cenojnë dhe diskreditojnë figurën dhe pozitën e tij të mos mbeten pa u ndëshkuar. Kushtetuta rregullon në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatimin për shkarkimin nga detyra të prokurorit, për të drejtën e ankimit ndaj vendimit të shkarkimit, si dhe organin për shqyrtimin e ankimit, duke dhënë garanci të plota për prokurorët në ushtrimin e funksionit të tyre. Nëse ligji do të parashikonte raste të tjera për shkarkimin e magjistratit përtej atyre të parashikuara në Kushtetutë, atëherë norma ligjore do të konsiderohej në tejkalim me parashikimin kushtetues[41]. Bazuar në qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në lidhje me nenin 4/3 të Kushtetutës, zbatimi i drejtpërdrejtë i dispozitave kushtetuese për shkarkimin nga detyra të magjistratit, për sa provohet sjellja e tij në shkelje të parashikimeve ligjore, vjen në përmbushje të parashikimeve të nenit 111 të ligjit 96/2016, që parashikojnë shkarkimin nga detyra të magjistratit, si masë disiplinore për *sjellje të kryer me pakujdesi të rëndë, që shkel haptazi vlerat themelore të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë*. Nga mënyra e formulimit, del e qartë që edhe vetë dispozita ligjore në këtë rast, i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë parashikimit të bërë nga neni 140, pika 2, shkronja "a" dhe neni 148/d, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës.

14.5.2 Kolegji e vlerëson të pabazuar pretendimin e kërkuesit se hetimi disiplinor për shkelje disiplinore të pretenduara të kryera në kohën kur nuk parashikoheshin të tilla nga ligji i posaçëm përbën motiv diskriminimi për subjektin e procedimit disiplinor, pasi në analizën e vendimit të KLP-së, paragrafët 5.9.2. dhe 5.10.3, shkeljet profesionale të magjistratit Shkëlqim Kokona janë vlerësuar sipas parashikimit të nenit 148/d të Kushtetutës, por edhe në raport me shkeljet e tjera objekt i procedimit disiplinor të periudhës 2018-2021: *[...] ndonëse pika 2 e nenit 101 të Ligjit për Statusin nuk ka qenë në fuqi në kohën kur kanë ndodhur një pjesë e fakteve objekt procedimi disiplinor, ato janë marrë në analizë me qëllim që subjekti i procedimit disiplinor të mos gjendet në një pozitë më pak të favorshme se çdo prokuror tjetër, veprimet/mosveprimet e të cilit mund të jenë kryer pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit 48/2019, për t'u vlerësuar nëse përbënin shkelje*

[40] Shih vendimin e Kolegjit nr. 1 (JD), datë 30.05.2022, paragrafët 12.2 e nënparagrafët vijues, ku për këtë pretendim, Kolegji ka konsideruar të ezauruar dhe shterues shpjegimin e dhënë nga KLP-ja në vendimin objekt shqyrtimi, se: "normalisht dispozita kushtetuese prevalon mbi çdo normë tjetër ligjore, bazuar kjo mbi parimin e hierarkisë së akteve, sanksionuar nga neni 4, pika 2, dhe neni 116 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në këto kushte, kur vetë Kushtetuta ka parashikuar një rregullim të posaçëm, i ngritur në nivel kushtetues, i zbatueshëm për rastin në procedim, si dhe bazuar mbi të drejtën e organit procedues për të referuar dhe zbatuar drejtpërdrejt Kushtetutën, vlerësohet se kriteri i përcaktuar në nenin 124 në lidhje me nenin 120, pika 1, shkronja "d" e Ligjit për Statusin, konsiderohet i përmbushur, duke legjitimuar verifikimin, hetimin dhe në vijim edhe procedimin disiplinor të magjistratit [...]".

[41] Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34/2017.

disiplinore, ku përveç parashikimeve kushtetuese do të merreshin në konsideratë edhe faktorët e sipërcituar [...].

14.5.3 Kolegji e vlerëson të pabazuar pretendimin se norma kushtetuese, neni 148/d, pika 1 e Kushtetutës, që sanksionon se: *Prokurori mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit*, në kuptimin formal ia ka deleguar rregullimin e ligjit dhe të çështjeve disiplinore ligjvënësit, dhe KLP-ja ka keqinterpretuar *parimin e specialitetit* dhe konceptin e *rezervës ligjore absolute*. Kolegji çmon të sjellë në vëmendje se norma kushtetuese nuk mund të lexohet e copëzuar, duke referuar vetëm në një paragraf të saj, por duhet të lexohet si një e tërë dhe nën frymën e qëllimit të kushtetutëbërësit, i cili rastet e shkarkimit apo pezullimit nga detyra të magjistratit, i parashikon përkatësisht në nenet 140 dhe 148/d të Kushtetutës. Në konsideratë të qëndrimit të tij[42], Kolegji sjell në vëmendje se në procedimin disiplinor në shqyrtim, *parimi i specialitetit* nuk gjen aplikim, pasi nuk është rasti i konfliktit ndërmjet një ligji specifik dhe një ligji të përgjithshëm, organi procedues ka aplikuar drejtpërdrejt normën kushtetuese që rregullon në mënyrë specifike çështjen e, për rrjedhojë, nuk mund të pretendohet konkurrimi mes saj dhe një norme ligjore. Lidhur me pretendimin për keqinterpretim të konceptit të "rezervës ligjore absolute", *sipas parimit lex superiori derogat lex inferiori - rregulli apo ligji më lart në hierarki mbizotëron ndaj ligjit më poshtë në hierarki,* Kolegji e vlerëson atë të pabazuar në ligj.

14.6 Magjistrati pretendon se në arsyetimin e vendimit të KLP-së nr. 411, datë 17.12.2021, nuk pasqyrohet asnjë nga pohimet dhe pjesa më e madhe e provave të depozituara prej tij, që sipas tij provon paligjshmërinë e procedurës në kuptim të parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, nenet 154, 214, 281, 310 dhe vijues të tij, të ligjit 49/2012, neneve 21 dhe 41 të tij, të ligjit 44/2015, nenit 100 të tij.

14.6.1 Nga analiza e vendimit objekt ankimi, Kolegji konstaton se pohimet e magjistratit janë pasqyruar në faqet 6 dhe 7 të tij dhe prej tij janë theksuar dy momente kryesore: 1) shkeljet e pretenduara të konstatuara janë të gjitha të parashkruara, pasi janë jashtë afatit 6-mujor të konstatimit; 2) vendimet që referohen për shkelje profesionale janë të fituara prej tij dhe janë të formës së prerë. Lidhur me pohimin e parë, Kolegji vlerëson se parashkrimi si një institut juridik, i cili sjell si pasojë humbjen e së drejtës për ndjekjen disiplinore të magjistratit, është parashikuar si një nga kriteret e pranueshmërisë së ankesës nga ana e ILD-së në nenin 120 të ligjit 96/2016[43] dhe lidhet me institutin e parashkrimit shues të procesit disiplinor, parashikuar në pikën 1 të nenit 117 të po këtij ligji[44]. Periudha për të cilën është hetuar dhe proceduar ankuesi, është verifikuar nga KLP-ja dhe është pasqyruar në vendim. Lidhur me pohimin e dytë, Kolegji vëren se shkeljet e kryera nga magjistrati janë provuar nga hetimi disiplinor i zhvilluar nga ILD-ja dhe në vijim janë shqyrtuar rast pas rasti nga KLP-ja gjatë procedimit disiplinor, ku i janë nënshtruar edhe debatit gjyqësor me praninë e palëve. Sa më sipër, provohet se KLP-ja ka vepruar në përputhje të plotë

---

[42]Shih vendimin e Kolegjit nr. 1(JD), datë 30.05.2022, paragrafët 12.10.1 e vijues.

[43] Ligji 96/2016, neni 120, pika 1, shkronja "b" parashikon: "1. Ankesa pranohet nëse përmbush kriteret e mëposhtme: [...] b) i referohet fakteve që kanë ndodhur brenda afatit të parashkrimit për hetimin [...]".

[44] Ligji 96/2016, në nenin 117, me titull "Afati i parashkrimit", parashikon: "Shkeljet disiplinore parashkruhen brenda pesë vjetëve. Nëse një ankesë, sipas nenit 119, të këtij ligji, paraqitet pas 5 vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk verifikon ankesën për shkak të parashkrimit. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr të dhëna, sipas nenit 124 të këtij ligji, pas 5 vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, ai nuk fillon hetimin për shkak të parashkrimit. 2. Afati i parashkrimit fillon nga momenti kur shkelja e pretenduar është kryer. 3. Nëse magjistrati kryen shkelje tjetër të së njëjtës natyrë brenda afatit të parashkrimit, afati zgjatet deri në një vit [...]".

me ligjin procedural civil dhe administrativ dhe pretendimi i ankuesit se në vendimin objekt ankimi nuk pasqyrohet asnjë prej pohimeve të magjistratit, vlerësohet prej Kolegjit i pabazuar në prova.

14.6.2 Lidhur me pretendimin se në vendimin objekt ankimi nuk pasqyrohet pjesa më e madhe e provave dhe vetëm një pjesë e vogël e dokumentacionit provues të depozituar nga ana e tij është pranuar nga KLP-ja, Kolegji konstaton se KLP-ja ka pranuar kërkesën e magjistratit për të paraqitur prova të reja [paragrafi 3.4.3 i vendimit] dhe është shprehur lidhur me pranueshmërinë e tyre [paragrafët 3.8 dhe 3.9 të vendimit]. Nga regjistrimi audio i seancës dëgjimore dhe nga përmbajtja e vendimit, provohet se KLP-ja është shprehur për të gjitha provat e kërkuara të merren prej magjistratit, i cili në asnjë moment nuk ka kërkuar marrjen si provë të ndonjë vendimi gjyqësor apo administrativ, dhe nuk ka pranuar vetëm njërën prej tyre – ligjin 8577/2000, si fakt i njohur publik. Magjistrati e ngre këtë pretendim duke u shprehur se KLP-ja duhej të mbante qëndrim *për secilën nga provat të konstatuara gjatë gjykimit,* pohim i cili provon se prej tij nuk është kërkuar marrja e ndonjë prove tjetër, përpos atyre të pasqyruara në vendim. Në kuptim të parashikimeve të nenit 12 të Kodit të Procedurës Civile, ka qenë detyrim i tij për të provuar, në përputhje me ligjin, faktet mbi të cilat bazon pretendimet e tij, përfshirë kërkesën për marrje të provave të çmuara të nevojshme për këtë qëllim. Sa më sipër, Kolegji e vlerëson të pabazuar pretendimin e magjistratit se vendimi i KLP-së vendoset në kushte paligjshmërie pasi, sipas tij, është marrë në kundërshtim me nenin 10 të Kodit të Procedurës Civile.

14.7 Magjistrati pretendon se KLP-ja ka shkelur nenin 6 të KEDNj-së, lidhur me procesin e rregullt ligjor, dhe se vendimi nr. 411, datë 17.12.2021, është në kundërshtim me praktikën e GjEDNj-së për sa i përket zbatimit të nenit 7 të KEDNj-së.

14.7.1 Kolegji vlerëson se pretendimet e magjistratit mbi të cilat ai mbështet ankimin për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, janë të pabazuara. *Së pari,* sipas magjistratit, KLP-ja duhej të merrte në konsideratë veprimet e pabazuara në ligj nga ILD-ja. Në aktet e procedimit disiplinor të përcjella nga KLP-ja në Kolegj, është edhe dokumenti "Relacion mbi propozimin për caktimin e datës së seancës dëgjimore në ngarkim të prokurorit Shkëlqim Kokona", i Komisionit Disiplinor, me nr. {***} prot., datë 19.10.2012. Nga përmbajtja e tij, Kolegji konstaton se në konsideratë të përcaktimeve ligjore për caktimin e datës së seancës dëgjimore brenda një muaji nga data e mbërritjes së dosjes nga ILD-ja të shoqëruar me raportin hetimor përkatës[45], për shkak se materiali ka qenë voluminoz [në total 6148 fletë], *afati njëmujor është vlerësuar i pamjaftueshëm për t'u njohur jo vetëm relatori dhe anëtarët e Komisionit Disiplinor me aktet e praktikës, por edhe anëtarët e Këshillit, në mënyrë që të garantohet një vendimmarrje objektive dhe e bazuar në ligj,* dhe për këtë shkak, prej këtij Komisioni, i është propozuar KLP-së zgjatja me dy muaj e afatit për caktimin e seancës dëgjimore në funksion të procedimit disiplinor[46]. Ky propozim është vlerësuar nga KLP-ja, e cila me vendimin nr. {***}, datë 20.10.2021, ka caktuar zhvillimin e seancës dëgjimore sipas afatit të kërkuar, më datë 13.12.2021. Referuar në "Relacionin përfundimtar mbi procedimin disiplinor nr. {***}, datë 11.10.2021, filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magjistratit Shkëlqim Kokona, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec", me nr. {***} prot., datë 15.12.2021, rezulton se Komisioni Disiplinor, pas zhvillimit të seancës dëgjimore, duke përfshirë edhe pohimet e magjistratit, i ka propozuar seancës

[45] Ligji 96/2016, në nenin 138, pika 2, shkronja "a" parashikon: "2. Këshilli: a) përcakton datën për seancën dëgjimore, e cila duhet të jetë brenda një muaji nga dita e marrjes së dosjes nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë […]".
[46] Ligji 96/2016, në nenin 138, pika 3, përcakton: "[…] 3. Këshilli mund të zgjasë afatin e parashikuar në pikën 2, shkronja "a" e këtij neni, deri në dy muaj, për shkaqe të rëndësishme, të cilat duhet të bëhen publike […]".

plenare të KLP-së dhënien e masës disiplinore në ngarkim të tij. Në vendim, në pjesët "Faktet e provuara" dhe "Analiza e fakteve dhe arsyetimi ligjor", KLP-ja ka pasqyruar në mënyrë të plotë faktet për të gjitha çështjet e hetuara disiplinarisht dhe i ka analizuar ato në mënyrë të pandikuar, dhe nuk evidentohet asnjë rrethanë që të përbëjë shkak për të pretenduar influencimin nga vlerësimi i ILD-së, e aq më pak që të mos ketë bërë një analizë të veçuar të çështjeve objekt procedimi disiplinor për të çmuar vlefshmërinë e pretendimeve të ILD-së rast pas rasti, sikundër pretendon magjistrati. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se fakti që qëndrimi i KLP-së nuk vjen në përputhje me qëndrimin apo interesin e magjistratit, nuk përbën shkak ligjor për të pretenduar se KLP-ja ka mbajtur një qëndrim sipërfaqësor lidhur me veprimtarinë e ILD-së, për rrjedhojë me pasojë shkeljen e parimeve të sanksionuara nga neni 6 i KEDNj-së.

14.7.2 Kolegji vlerëson të pabazuar edhe pretendimin tjetër për anomali të kuadrit ligjor për sa i përket një gjykate të paanshme, mbi të cilin magjistrati mbështet pretendimin për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së. Sipas tij, parashikimet e nenit 194 të ligjit nr. 115/2016[47], bëjnë të pamundur që në kontekstin e një gjykatë të paanshme, veprimtaria e KLP-së të ishte e disfavorshme për ILD-në, dhe në këtë kontekst referon konsiderimet e GjEDNj-së lidhur me paanësinë e gjykatës: *mungesë e paragjykimit ose mungesë absolute të dyshimit të ekzistencës së njëanshmërisë*[48]. Referimi vetëm në një dispozitë të ligjit 115/2016, nenin 194 të tij, duke anashkaluar dispozitat e tjera të këtij ligji, si edhe garancitë kushtetuese e parashikimet e kuadrit ligjor në fuqi, të cilat përcaktojnë norma dhe rregulla që garantojnë paanësinë e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, përfshirë këtu KLP-në dhe ILD-në, me qëllim shmangien e çdo dyshimi për dukje anshmërie, qoftë edhe në pamje të jashtme, në funksion të forcimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, vlerësohet prej Kolegjit i pabazuar dhe tendencioz. Referuar në jurisprudencën e GjEDNj-së, të sjellë në referim nga magjistrati për të mbështetur pretendimet e tij[49], gjykata ka theksuar se ka dy situata të mundshme lidhur me paanësinë e gjykatës, e para është *funksionale* dhe për vetë natyrën e saj, ka të bëjë me lidhje hierarkike apo të tjera midis personave në proces, dhe e dyta ka *karakter personal* dhe ka si zanafillë sjelljen e një gjyqtari të caktuar. Lidhur me situatën e parë, të dyja institucionet e përfshira në këtë procedurë, janë të pavarura dhe midis tyre nuk ka asnjë lidhje hierarkie. Ligji 115/2016 përcakton kompetencën e ILD-së për të hetuar disiplinarisht anëtarët e KLP-së, por njëherazi në nenin 104[50] përcakton se procedimi disiplinor për ta zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese. Në këtë kontekst, pretendimi i magjistratit nuk është objektivisht i përligjur[51]. Sa i përket *kriterit personal*, magjistrati nuk referon për dyshime të tij për paanësinë e ndonjërit prej anëtarëve të KLP-së dhe, referuar në kriteret e

---

[47] Ligji 115/2016, në nenin 194 parashikon: "Inspektori i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë [...]".

[48] Vendime të GjEDNj-së, çështjet Padovani kundër Italisë; Piersack kundër Belgjikës; Kyprianou kundër Qipros.

[49] Vendim i GjEDNj-së, çështja Kyprianou kundër Qipros, paragrafi 121.

[50] Ligji 115/2016, në nenin 104, përcakton: "Shkeljet disiplinore të anëtarit të Këshillit të Lartë Prokurorisë hetohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në bazë të procedurave dhe rregullave të ligjit, të parashikuara në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". 2. Gjykata Kushtetuese shqyrton ankimet kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose mbylljen e hetimit ndaj anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. 3. Gjykata Kushtetuese vendos pezullimin e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në rastet e parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. 4. Procedura disiplinore ndaj anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila vendos në bazë të ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

[51] Vendim i GjEDNj-së, çështja Ferantelli e Santiangelo kundër Italisë, parag.58, Padovani kundër Italisë parag. 27.

përzgjedhjes dhe emërimit, anëtarët e KLP-së, profesionistë me përvojë dhe profesionalizëm të spikatur, japin garanci për shmangien e ndikimeve të jashtme në proces[52].

14.7.3 Kolegji vlerëson të pabazuar pretendimin se vendimi nr. 411, datë 17.12.2021, i KLP-së është në kundërshtim me praktikën e GjEDNj-së për sa i përket zbatimit të nenit 7 të KEDNj-së, të cilin magjistrati e mbështet me pretendimin se një pjesë e materialeve të referuara në kallëzimet e hetuara nga ILD-ja, është në mungesë të bazës ligjore për të përcaktuar atë që ligji material nr. 96/2016 (*për shkak të vakumit ligjor të përkohshëm*) dhe pika 1 e nenit 148/d të Kushtetutës konsiderojnë shkelje disiplinore. Kolegji sjell në vëmendje se nocioni "e drejtë", i përdorur në nenin 7 të KEDNj-së, që i përgjigjet atij "ligji" që figuron në nenet e tjera të Konventës, përfshin të drejtën me prejardhje si nga legjislacioni, ashtu edhe nga jurisprudenca e gjykatave, dhe nënkupton disa kushte cilësore, ndër të tjera edhe të mundësisë së parashikueshmërisë[53]. Gjykata Kushtetuese nëpërmjet vendimit nr. 75/2002, arsyeton se: *Shprehja "akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën [...]", parashikuar nga nenet 128, 140 dhe 149, pika 2 e Kushtetutës, përmbledh në vetvete një sërë elementesh, të cilat mund dhe duhet të identifikohen rast pas rasti nga organi përkatës që merr vendimin për shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe Prokurorit të Përgjithshëm. Ato janë të lidhura me aktet dhe sjelljet e parregullta e të padenja që këta funksionarë të lartë kryejnë gjatë ushtrimit të detyrës, për shkak të saj, por edhe jashtë detyrës. Këto veprime apo mosveprime që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momentit subjektiv, si dhe nga dëmet që ato i sjellin shoqërisë e shtetit, janë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese nga këto subjekte.* Referimi në këtë vendimmarrje të Gjykatës Kushtetuese, tregon se vendimmarrja e institucioneve proceduese është mbështetur në standarde të analizuara dhe të përcaktuara nga Gjykata Kushtetuese. Kolegji çmon të sjellë në vëmendje se edhe vetë Gjykata Kushtetuese ka referuar në standarde të vendosura nëpërmjet vendimmarrjeve të saj, pavarësisht se norma kushtetuese mund të ishte ndryshuar në kohë nga kushtetutëbërësi[54].

15 *Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkeljet e rënda profesionale dhe etike të kryera nga magjistrati, objekt shqyrtimi në KLP*

15.1 Lidhur me refuzimin për marrjen në dorëzim të dosjeve ose materialeve kallëzuese, të caktuara nëpërmjet procedurës së shortit.

15.1.1 Nga shqyrtimi i akteve, KLP-ja ka konstatuar se më datë 06.01.2020, sipas rezultatit të shortit, prokurorit Shkëlqim Kokona i janë caktuar tri nga dosjet e ardhura për kompetencë nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, dhe ai nuk ka pranuar të marrë në dorëzim dy prej tyre [dokumentuar me procesverbal]. Në këtë situatë, është thirrur mbledhje nga ana e drejtuesi i Prokurorisë, ku prokurori Shkëlqim Kokona, megjithëse i njoftuar verbalisht nga sekretaret e Prokurorisë, nuk ka marrë pjesë, pa paraqitur argument për mungesën e tij[55]. Çështja kryesore e diskutuar nga drejtuesi i Prokurorisë në këtë mbledhje, është shqetësimi për situatën e krijuar dhe mundësia e shpërndarjes së dosjeve në prokurorë të tjerë, përfshirë edhe vetë drejtuesin, dhe nga të pranishmit në mbledhje është diskutuar edhe për sjelljet joetike të prokurorit Shkëlqim Kokona ndaj drejtueses së Prokurorisë, prokurores D. B., oficerëve të policisë

---

[52] Vendim i GjEDNj-së, çështja Previti kundër Italisë, paragrafi 253.
[53] Shih: https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_7_SQI.pdf, "Udhëzues rreth nenit 7 të KEDNj-së".
[54] Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 1, datë 16.02.2022, paragrafi 138.
*[55] Procesverbali i mbledhjes nr. {***} prot., datë 21.01.2020.*

gjyqësore dhe ndaj stafit të Prokurorisë. Dy dosjet e refuzuara nga prokurori Shkëlqim Kokona janë marrë për ndjekje nga drejtuesi i Prokurorisë, i cili në shkresën drejtuar KLP-së dhe Prokurorit të Përgjithshëm[56], shprehet se: *[…] jemi të detyruar t'ju informojmë në lidhje me veprimet e paligjshme në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës së prokurorit, kompetencat e dhëna nga ligji, dhe sidomos në lidhje me sjelljet aspak etike në kufijtë e veprave penale të prokurorit Shkëlqim Kokona. [...] ajo që është më shqetësuese, është sjellja e tij me procedimet penale të ardhura për kompetencë nga Prokuroria e Posaçme për Krimet e Rënda, ndërkohë që disa prej tyre edhe me masa sigurimi që rrezikonin të shuheshin […].*

15.1.2 KLP-ja, nga shqyrtimi i akteve, gjithashtu ka konstatuar se sipas informacionit të drejtuesit të Prokurorisë adresuar ILD-së[57], drejtuesi i Prokurorisë ka nxjerrë urdhrin nr. {***} prot., datë 09.06.2020, "Për rishpërndarjen e dosjeve të lëna nga prokurori S. K.", dhe bazuar në ngarkesën edhe me detyra administrative të prokurores D. B., e caktuar drejtuese e Prokurorisë me vendimin nr. {***}, datë 21.05.2020, të KLP-së, është caktuar ngarkesa e reduktuar për të në 1/3 e dosjeve [në hetim dhe në fazë gjykimi] dhe 2/3 e dosjeve për prokurorin Shkëlqim Kokona, duke theksuar se për rishpërndarjen mes saj dhe prokurorit Kokona të dosjeve të lëna nga prokurori K., është konsideruar për zbutjen e diferencave në funksion të një ngarkesë pothuaj të barabartë mes tyre, duke pasqyruar në urdhër raportin krahasues prokuror/numër çështjesh për secilin nga dy prokurorët në detyrë *[pavarësisht organikës së Prokurorisë me katër prokurorë]*.
Prokurori Shkëlqim Kokona nuk ka marrë pjesë në shortin e zhvilluar më datë 09.06.2020, dhe më tej ka refuzuar të marrë në dorëzim çështjet e shortuara, pa formalizuar me akt të shkruar arsyet e refuzimit. Procedimi penal nr.{***}, i caktuar prokurorit Shkëlqim Kokona me shortin e datës 09.06.2020, është tërhequr prej tij më datë 01.07.2020 dhe është dorëzuar sërish në sekretari duke u shprehur për shkaqe për të cilat, sipas tij, nuk mund ta hetonte, por pa deklarim me shkrim për heqje dorë[58]. Drejtuesja e Prokurorisë ka informuar KLP-në dhe Prokurorin e Përgjithshëm për refuzimin e marrjes të dosjeve në dorëzim nga prokurori Shkëlqim Kokona, duke shprehur shqetësimin se për këtë shkak këto dosje do të mbeten pa veprime hetimore dhe pa përfaqësim në gjykatë[59]. Për identifikimin e problematikës, rasti është monitoruar nga Prokurori i Përgjithshëm, nëpërmjet Sektorit të Monitorimit. Magjistrati i vënë në dijeni për përpilimin e informacionit ndaj tij[60], me elemente të shkeljes disiplinore, për të cilin i është kërkuar të paraqesë qëndrimin e tij për faktet dhe rrethanat e pretenduara, në informacionin e parë, ka ngritur pretendime për *informacion të falsifikuar, si shkak pse ka refuzuar marrjen e dosjeve të lëna nga prokurori S. K., pasi sipas tij, dosjet janë të manipuluara dhe të falsifikuara,* dhe në informacionin e dytë ka paraqitur pretendime se *pas studimit të dosjeve, ka konstatuar shumë parregullsi të natyrës procedurale dhe materiale në përmbajtjen e dosjeve*. Në përfundim të verifikimeve të kryera nga Sektori i Monitorimit, Prokurori i Përgjithshëm ka vlerësuar se veprimet e prokurorit Shkëlqim Kokona për mospjesëmarrje në shortin e datës 09.06.2020, si dhe mosmarrja prej tij në administrim e dosjeve penale të shortuara përbëjnë shkelje disiplinore në lidhje me funksionin e tij si magjistrat sipas nenit 102, pika 1, shkronja "b" e ligjit 96/2016. Për këto veprime/mosveprime, por edhe për raste

*[56] Shkresa nr. {***} prot., datë 23.01.2020, me lëndë "Dërgohet informacion në lidhje me prokurorin Shkëlqim Kokona", drejtuar KLP-së dhe Prokurorit të Përgjithshëm.*
*[57] Shkresa nr. {***} prot., datë 26.01.2021.*
*[58] Procesverbalet nr. {***} prot., datë 10.06.2020 dhe nr. {***} prot., datë 1.07.2020, nënshkruar nga kryesekretarja dhe dy sekretare të Prokurorisë.*
*[59] Shkresa nr. {***} prot., datë 12.06.2020.*
[60] Komunikim përmes postës elektronike, në periudhën 29.06.2020 - 02.07.2020.

të tjera të evidentuara, Prokurori i Përgjithshëm ka kërkuar nga ILD-ja nisjen e procedurës së inspektimit për hetimin e shkeljeve individuale të kryera nga prokurori Shkëlqim Kokona[61].

15.1.3 Lidhur me kallëzimet penale me nr. {***} dhe {***}, të regjistruara në Prokurori më datë 26.12.2019, KLP-ja, nga shqyrtimi i akteve ka konstatuar se ato janë shpërndarë me short dhe i janë dorëzuar prokurorit Shkëlqim Kokona, i cili në datën 08.01.2020, i ka kthyer në sekretari pasi *[...] nuk ishte dakord t'i hetonte me arsyetimin se duhej t'i merrte prokurori që kishte qenë i gatshëm më datë 26.12.2019, por nuk pranonte të jepte dorëheqje me shkrim [...]*[62]. Për kallëzimin 791/2019, në ngarkim të shtetasit A. H. për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, drejtuesi i Prokurorisë, me vendimin e datës 08.01.2020, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit Shkëlqim Kokona me prokurorin S. K.. Në vendim arsyetohet se: *[...] për rreth 13 ditë nga hedhja e shortit, prokurori Shkëlqim Kokona nuk ka pranuar të marrë në dorëzim aktet e kallëzimit penal, me arsyetimin se në kohën e ngjarjes punonjësit e policisë kanë folur në telefon me drejtuesin e Prokurorisë. Ndonëse nuk ka shkaqe ligjore për zëvendësimin e prokurorit, duke marrë në konsideratë faktin se vendimi i mosfillimit mund të merret brenda një afati pesëmbëdhjetëditor nga regjistrimi i kallëzimit penal, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë, ndonëse sjellja e prokurorit të çështjes, z. Shkëlqim Kokona, është në shkelje të përmbushjes së detyrimeve të tij si prokuror, me qëllim kryerjen e një vendimmarrjeje sa më eficiente dhe ligjore, çmoj të bëhet zëvendësimi i prokurorit. Në lidhje me këtë fakt, duhet të njoftohet edhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.* Sa i përket kallëzimit penal {***}, materiali hetimor është sjellë nga Komisariati i Policisë Pogradec në ngarkim të shtetasit E. D., për vlerësim. Drejtuesi i Prokurorisë, për kallëzimin penal, me vendimin e datës 24.01.2020, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit Shkëlqim Kokona me prokuroren D. B.. Në vendim arsyetohet se: *[...] Ndonëse nuk ka shkaqe ligjore për zëvendësimin e prokurorit, duke marrë në konsideratë faktin se vendimi i mosfillimit mund të merret brenda një afati pesëmbëdhjetëditor nga regjistrimi i kallëzimit penal, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë, ndonëse sjellja e prokurorit të çështjes, z. Shkëlqim Kokona, është në shkelje të përmbushjes së detyrimeve të tij si prokuror, me qëllim kryerjen e një vendimmarrje sa më eficiente dhe ligjore, çmoj të bëhet zëvendësimi i prokurorit. Në lidhje me këtë fakt, duhet të njoftohet edhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.* Prokurorja zëvendësuese D. B., më datë 24.01.2020, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal më datë 24.01.2020, për veprën penale "vrasje", parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal.

15.1.4 KLP-ja ka konkluduar se: për shpërndarjen e dosjeve të ardhura nga ish-Prokuroria për Krime të Rënda, shortuar më datë 06.01.2020; rishpërndarjen e dosjeve të prokurorit S. K., të shortuara më datë 09.06.2020; për kallëzimet me nr. {***} dhe {***}, sipas shortit të datës 26.12.2019, rezulton e provuar se nga ana e drejtuesve të Prokurorisë është vepruar mbi bazën e nenit 53 të ligjit 97/2016 dhe të urdhrit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. {***}, datë 29.12.2006, "Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori", të cilët rregullojnë shpërndarjen e drejtë të ngarkesës mes prokurorëve, duke siguruar paanshmërinë, pavarësinë dhe efikasitetin e punës së prokurorisë. Në këtë situatë faktike, veprimet/mosveprimet e prokurorit Shkëlqim Kokona: për të pranuar vetëm një dosje nga tri të shortuarat më datë 06.01.2020, për të mos marrë në dorëzim dosjet e shortuara më datë 09.06.2020 [14 dosje në hetim dhe 21 dosje në gjykim], duke tërhequr më datë 01.07.2020 vetëm 7 dosje në hetim, për të kthyer në sekretari kallëzimet me nr. {***} dhe {***},

[61] *Shkresa nr. {***} prot., datë 30.10.2020, "Kërkesë për nisjen e inspektimit disiplinor për shkelje individuale".*
[62] *Sipas procesverbalit të datës 08.01.2020,, mbajtur mes kryesekretares dhe dy sekretareve të Prokurorisë, nënshkruar prej tyre dhe drejtuesit të Prokurorisë S. K..*

duke i lënë pa veprime respektivisht për 1 muaj e 13 ditë, pa asnjë akt dorëheqjeje që do të sillte vlerësimin e zëvendësimit të tij, vijnë në kundërshtim me nenet 24, 25, 304 të K.Pr.Penale, nenet 4, 5, 6 dhe 11 të ligjit 97/2016, nenin 3 të ligjit 96/2016 dhe përbëjnë shkelje disiplinore referuar në parashikimet e nenit 102, pika 1, shkronja "ç" e ligjit 96/2016 "mospërmbushje e pajustifikuar ose e përsëritur e funksioneve gjatë gjykimit ose hetimit". Për dosjet e shpërndara me shortin e datës 09.06.2020, marrja e 7 prej tyre pas afro 1 muaji, tregon për kryerjen e shkeljes së parashikuar nga neni 102, pika 1, germa "b/", nënpika "ii" e ligjit 96/2016.

15.1.5 Magjistrati pretendon se nuk ka bërë asnjë shkelje të dispozitave procedurale dhe as të akteve të Prokurorit të Përgjithshëm. Lidhur me dosjet e ardhura nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, pretendon se janë çështje të filluara nga prokurori S. K.; për rishpërndarjen e dosjeve të prokurorit S. K., pretendon se ka bërë debat për shkak të ngarkesës së punës, 450 çështje ose 2/3 e ngarkesës së gjithë Prokurorisë, se u caktua nga KLP-ja prokurori i komanduar dhe kërkon që të mbahet parasysh informacioni i tij për prokurorin e Prokurorisë së Përgjithshme, z. A. Ç., lidhur me veprimet korruptive të prokurorit S. K. me dosjet e lëna pa lëvizje, për të cilat ka konsumuar krimin e shpërdorimit të detyrës dhe dyshime të forta për korrupsion pasiv, sipas tij. Lidhur me kallëzimet penale nr. 788 dhe 791 të vitit 2019, ankuesi i pasqyron në ankim pa ngritur asnjë pretendim, ndërsa në parashtrime për procedimin nr. {***} pretendon se është kundravajtje penale, ndërsa për procedimin nr. {***} shprehet se kallëzimi është bërë nga shoqata e të përndjekurve politikë për një vrasje të 80-viteve përpara.

15.1.6 Lidhur me sa më sipër, Kolegji çmon se magjistrati ka kryer shkelje procedurale duke ndërmarrë veprime dhe mosveprime të cilat përbëjnë mospërmbushje të detyrës sipas parashikimit të nenit 24, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se: *Prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyr ekzekutimin e tyre, si dhe ushtron funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja, sipas rregullave të caktuara në këtë kod.* Magjistrati nuk ka zbatuar detyrimin që buron nga ligji penal lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale për çështjet e caktuara për ndjekje dhe veprimet/mosveprimet e tij dëshmojnë se nuk është udhëhequr nga respektimi i ligjit. Refuzimi i tij për të marrë dosjet në dorëzim do të thotë refuzim për të ushtruar funksionin e prokurorit, për sa prej tij nuk është ndërmarrë asnjë veprim për heqjen dorë sipas parashikimeve të nenit 27 të Kodit të Procedurës Penale, apo për të ushtruar ankim ndaj drejtuesit të Prokurorisë, sipas parashikimeve të nenit 47 të ligjit 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar[63]. Për veprimet në shkelje të parashikimeve ligjore të shoqëruara me pasojën e lënies së dosjeve pa veprime hetimore, në dëm të personave subjekt i këtyre procedimeve, të kryera në mënyrë të përsëritur, Kolegji e gjen të bazuar konkluzionin e KLP-së për kualifikimin e tyre si shkelje profesionale të magjistratit, dhe pretendimet e tij në ankim i vlerëson të pabazuara në ligj e në prova. Sa i përket pretendimit të magjistratit në ankim, *[...] të kihet parasysh informacioni i tij për prokurorin e Prokurorisë së Përgjithshme, z. A. Ç., lidhur me veprimet, korruptive të prokurorit S. K. me dosjet e lëna pa lëvizje për të cilat ka konsumuar krimin e shpërdorimit të detyrës dhe*

[63] *Ligji 97/2016, në nenin 47, me titull "Kundërshtimi i udhëzimeve të përgjithshme", parashikon: "1. Prokurori mund të kundërshtojë paligjshmërinë apo pabazueshmërinë e udhëzimeve të përgjithshme, duke bërë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. 2. Prokurori është i detyruar të ndjekë udhëzimet e ankimuara, me përjashtim të rastit kur vlerëson se ato janë haptazi në kundërshtim me ligjin. 3. Prokurori nuk mban përgjegjësi për ankimin dhe moszbatimin e udhëzimit, përveçse kur vepron haptazi në kundërshtim me ligjin dhe vepron me keqdashje ose pakujdesi të rëndë".*

dyshime të forta për korrupsion pasiv, Kolegji vlerëson se vjen në tejkalim të kompetencave të tij për gjykimin e çështjeve të juridiksionit disiplinor, dhe nga aktet e procedimit disiplinor rezulton se Prokurori i Përgjithshëm, në dijeni të këtij informacioni dërguar prej magjistratit si shkak për të cilin prej tij ishte refuzuar marrja e dosjeve, ka vlerësuar t'i propozojë ILD-së fillimin e hetimit disiplinor për magjistratin.

15.2 *Procedimi penal nr. {***}, datë 24.02.2019*

15.2.1 KLP-ja, nga aktet në dosje, ka konstatuar se për procedimin penal nr. {***}, datë 24.02.2019, në ngarkim të shtetasit E. Ç., i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Prodhim dhe shitje të narkotikëve", parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, prokurori Shkëlqim Kokona ka përpiluar kërkesën për vleftësimin e masës së arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit, si dhe ka përfaqësuar organin e prokurorisë në seancën gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë Pogradec, e cila me vendimin nr. {***}, datë 26.02.2019, pasi ka vleftësuar arrestin dhe ka caktuar masën e sigurimit, ka shpallur moskompetencën tokësore dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, si gjykatë kompetente për gjykimin e masës. Ky vendim, i ankimuar nga personi nën hetim, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. {***}, datë 20.03.2019, e cila sipas objektit të ankimit ka shqyrtuar vetëm lidhur me masën e sigurimit, pa u shtrirë në moskompetencën tokësore. Prokurori Shkëlqim Kokona ka pretenduar se vendimi i gjykatës nuk ishte i detyrueshëm për të[64], me gjithë udhëzimin jodetyrues të datës 28.02.2019, të nxjerrë nga drejtuesi i prokurorisë për shpalljen e moskompetencës tokësore. Mosveprimi ka vijuar prej tij edhe pasi Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan kishte proceduar me vleftësimin e masës së sigurimit në bazë të nenit 88 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe të dy shkresave të dërguara nga Prokuroria Elbasan për këtë çështje[65]. Prej prokurorit Shkëlqim Kokona, më datë 16.04.2019, i janë është dërguar Prokurorisë Elbasan kopje të njësuara të akteve, pasi nuk pranonte të dërgonte origjinalin, me pretendimin e ankimit në Gjykatën e Apelit Korçë. Në situatën kur veprimet hetimore që mund të kryheshin mund të shpalleshin të papërdorshme, drejtuesja e Prokurorisë Elbasan i është drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, i cili i është drejtuar Prokurorisë Pogradec për dërgimin e akteve dhe të informacionit se përse nuk vlerësohej shpallja e moskompetencës. Në përgjigjen e kthyer nga drejtuesi i Prokurorisë më datë 24.05.2019, është shpjeguar se nga ana e prokurorit Shkëlqim Kokona nuk ishte përgatitur informacioni i kërkuar dhe, për këtë arsye, nga ana e tij po dërgohej fashikulli origjinal.

15.2.2 KLP-ja ka konkluduar se rrethanat e faktit, përpos faktit penal të kompetencës tokësore të ushtrimit të ndjekjes penale, të cilat tregojnë që edhe pse ka qenë i qartë detyrimi si prokuror i çështjes për të kaluar aktet origjinale të procedimit penal nr. {***}, datë 24.02.2019, në Prokurorinë Elbasan, prej magjistratit nuk është vepruar, mosveprim i cili përveçse ka shkaktuar zvarritje në kryerjen e veprimeve hetimore për rreth tre muaj të çështjes që kishte të regjistruar person nën hetim, me masë sigurimi "arrest me burg", diktonte vëmendje kujdesin jo vetëm për afatin hetimor, por dhe për afatin e paraburgimit. Bazuar në këtë analizë, KLP-ja ka vlerësuar mospërmbushje të funksionit të prokurorit sipas parashikimeve të neneve 76 dhe 28 të K.Pr.Penale.

15.2.3 Magjistrati pretendon se konflikti i kompetencës mes Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec dhe Prokurorisë Elbasan për procedimin penal nr. {***}, viti 2019,

---

*[64] Referojuni informacionit të drejtuesit të prokurorisë, nr. {***} prot., datë 22.01.2020, drejtuar KLP-së dhe Prokurorit të Përgjithshëm.*

[65] Shkresa, datë 16.04.2019, e ripërsëritur më datë 23.04.2019.

është zgjidhur normalisht në bazë të ligjit nga Prokurori i Përgjithshëm, dhe në parashtrime ngre pretendimin se vonesa prej tre muajsh është shkaktuar nga Prokuroria e Elbasanit dhe Prokuroria e Përgjithshme. Sipas tij, ai ka nisur menjëherë dosjen në Prokurorinë e Elbasanit sapo ka ardhur vendimi i Prokurorit të Përgjithshëm, dhe se ky rast është parashkruar për shkak të kalimit të afatit 6-mujor nga konstatimi i shkeljes së pretenduar.

15.2.4 Kolegji, nga analiza e vendimit të KLP-së, si dhe nga aktet në dosje, vlerëson se pretendimi i magjistratit është i pabazuar në ligj e në prova. Prokurori i Përgjithshëm informohet dhe vendos se cila prokurori duhet të procedojë në rastet e parashikuara në nenin 29 të K.Pr.Penale[66]. Në rastin e procedimit penal nr. {***}, viti 2019, çështja e kompetencës ishte disponuar me vendim të gjykatës, për të cilin magjistrati ishte në dijeni, për rrjedhojë kishte detyrimin për të zbatuar parashikimet e nenit 28 të K.Pr.Penale[67]. Gjithashtu, bazuar në parashikimet e nenit 117 të ligjit 96/2016, Kolegji vlerëson se pretendimi i magjistratit lidhur me parashkrimin e kësaj shkeljeje, është i pabazuar.

15.3 *Përfundimi i çështjeve penale të regjistruara si vepra penale që kualifikohen krime, me vendim pushimi nga ana e magjistratit*

15.3.1 KLP-ja ka konstatuar se prokurori Shkëlqim Kokona, në cilësinë e prokurorit, ka vendosur pushimet e procedimeve penale me nr. {***} të vitit 2018, nr. {***} të vitit 2018 dhe nr. {***}, datë 17.02.2021, të regjistruara për veprën penale të "Dhunës në familje", parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal; të procedimeve penale me nr. {***}, datë 17.10.2020[68] dhe nr. {***}, datë 09.01.2021, të regjistruar për veprën penale "Ndërtim pa leje", parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal; të procedimit penal me nr. {***}, të regjistruar për veprën penale "Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor", parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal. Referuar parashikimeve të nenit 1 të Kodit Penal[69], KLP-ja ka analizuar se për veprat penale që legjislatori i konsideron kundërvajtje penale, është shprehur në dispozitë, duke i dalluar qartë ato nga veprat penale të cilat janë krime. Nga përmbajtja e dispozitave për të cilat janë regjistruar procedimet penale të sipërcituara, në asnjë prej tyre nuk ka parashikim për kundërvajtje penale. KLP-ja ka konkluduar se duke vendosur pushimin e çështjes për këto procedime penale, prokurori Shkëlqim Kokona ka vepruar në kundërshtim me ligjin procedural penal, nenin 228, pika 1, germa "b", ku parashikohet se kur procedohet për kundërvajtje penale, në përfundim të hetimeve paraprake, kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, prokurori vendos pushimin e akuzës, për më tepër, kur drejtuesi i Prokurorisë ka nxjerrë udhëzimet jodetyruese me të cilat udhëzonte kërkimin e

[66] Kodi i Procedurës Penale, në nenin 29 parashikon "Kur prokurori merr dijeni se pranë një prokurorie tjetër janë duke u zhvilluar hetime paraprake në ngarkim të të njëjtit person dhe për të njëjtin fakt, në lidhje me të cilin ai procedon, njofton pa vonesë atë prokurori, duke i kërkuar dërgimin e akteve. 2. Prokurori që ka marrë kërkesën, kur nuk është dakord me të, informon Prokurorin e Përgjithshëm, i cili pasi të ketë marrë të dhënat e nevojshme, vendos, sipas rregullave, mbi kompetencën e gjykatës se cila prokurori duhet të procedojë dhe njofton prokuroritë e interesuara. Prokurorisë së caktuar i dërgohen menjëherë aktet nga prokuroria tjetër [...]".

[67] Kodi i Procedurës Penale, në nenin 28 parashikon: "Kur gjatë hetimeve paraprake, prokurori çmon se vepra penale është në kompetencën e një gjykate të ndryshme nga ajo pranë së cilës ushtron funksionet e tij, ia kalon menjëherë aktet prokurorisë pranë gjykatës kompetente".

*[68] Për procedimin penal me nr. {***}, ka një vendimmarrje të gjykatës për kthimin e akteve prokurorit për t'u proceduar në bazë të nenit 329/a të KPrP, e cila megjithëse ka marrë formë të prerë, nuk është pranuar si e tillë, duke u ankimuar nga prokurori Shkëlqim Kokona.*

[69] Kodi Penal, në nenin 1, me titull "Ligji penal dhe ndarja e veprave penale", parashikon: "Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre. Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat e pjesës së posaçme të këtij Kodi".

pushimit për çështjen në gjykatë [70], por prokurori nuk ka ndryshuar qëndrimin e tij dhe ka vijuar me njoftimin e vendimmarrjes palëve të interesuara. Referuar në parashikimet e nenit 148/d të Kushtetutës, për procedimet penale me nr. 24 të vitit 2018 dhe nr. 459 të vitit 2018, KLP-ja ka vlerësuar se vendimmarrja e prokurorit vjen në kundërshtim me nenet 328, 329/a të K.Pr.Penale, si dhe me nenet 24 dhe 25 të K.Pr.Penale, që parashikojnë funksionet e prokurorit si organ që ushtron ndjekjen penale, për rrjedhojë konsiderohen se përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit procedural penal, në drejtim të ushtrimit të ndjekjes penale nga ana e prokurorit dhe ushtrimit të kontrollit gjyqësor të parashikuar për rastin e krimeve, si dhe të pasojave që krijojnë në shmangien nga vlerësimi i përgjegjësisë penale të personit të dyshuar për kryerjen e veprës penale. Për procedimet penale të viteve 2020 dhe 2021, KLP-ja ka vlerësuar se përbëjnë shkelje në të njëjtat konsiderata si procedimet penale të vitit 2018, por referuar ligjit 96/2016, parashikohen si të tilla në nenin 102, germat " c" dhe "dh" të tij.

15.3.2 Magjistrati pretendon se ka disponuar me vendim pushimi këto procedime penale pasi, sipas tij, dispozitat e Kodit Penal të cilat parashikojnë veprat penale për të cilat janë regjistruar këto procedime, nenet 130/a/1, 199/a/1 dhe 290/1, janë kundërvajtje penale dhe se vendimet janë në fuqi.

15.3.3 Kolegji, nga analiza e vendimit të KLP-së, si dhe nga aktet në dosje vlerëson se pretendimi i magjistratit është i pabazuar, për shkak të parashikimeve të qarta të ligjit penal, sikundër është analizuar nga KLP-ja. Gjithashtu, pretendimi i tij duket abuziv për shkak të eksperiencës së gjatë, rreth 28-vjeçare të magjistratit në ushtrimin e funksionit të prokurorit, çka hedh poshtë mosnjohjen e ligjit penal dhe, nga ana tjetër, është tregues i sjelljes së tij profesionale duke mos mbajtur në konsideratë ndjeshmërinë dhe sensibilitetin shoqëror lidhur me këto vepra penale, veçanërisht me atë të dhunës në familje[71]. Kolegji e vlerëson jorelevant pretendimin e magjistratit se vendimet janë në fuqi, pasi ky fakt nuk ka peshë për shkeljen disiplinore të kryer prej tij.

15.4 *Refuzimi për të marrë pjesë në seancat gjyqësore*

15.4.1 KLP-ja, ka konstatuar se prokurori Shkëlqim Kokona në mënyrë të vullnetshme nuk ka marrë pjesë dhe është bërë shkak për shtyrje, në seancat gjyqësore për gjykimin e të pandehurit A. K., për shqyrtimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit të shtetasit R. A. dhe të gjykimit të të pandehurit O. V..

15.4.1.1 Për gjykimin në ngarkim të të pandehurit A. K., prokurori Shkëlqim Kokona është bërë shkak për mosvazhdimin e seancës së gjykimit të themelit të datës 15.11.2018, duke pretenduar se do të jepte dorëheqjen para drejtuesit të Prokurorisë, por që nuk e ka kryer, nuk ka marrë pjesë në seancën gjyqësore me objekt shuarjen e masës së sigurimit në datën 22.11.2018 dhe në seancën gjyqësore të gjykimit të themelit të çështjes më datë 26.11.2018. Nisur nga ky fakt, pas njoftimit të marrë edhe gjykata, drejtuesi i Prokurorisë ka përfaqësuar organin e prokurorisë në këtë çështje.

---

*[70] Drejtuesi i Prokurorisë ka nxjerrë udhëzime ku udhëzonte kërkimin e pushimit për çështjen në gjykatë, respektivisht: nr. {***}, datë 02.05.2019, për procedimin penal {***}; nr. {***}, datë 16.04.2021, për procedimin penal {***}; nr. {***}, datë 23.04.2021, për procedimin penal {***}; nr. {***}, datë 29.06.2021, për procedimin penal {***}; nr. {***}, datë 28.06.2021, për procedimin penal {***}.*

[71] Shih: https://www.pp.gov.al/Dokumente/ raportet vjetore të Prokurorit të Përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit në ven; shih vendimin e GjEDNj-së, çështja Tërshana kundër Shqipërisë.

Pretendimet e prokurorit për këtë çështje, referuar kallëzimit të bërë prej tij, janë bërë objekt shqyrtimi nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila ka vendosur pushimin e çështjes duke mos gjetur elemente të veprës penale. Vendimi për mosfillimin e procedimit penal i është njoftuar prokurorit Shkëlqim Kokona me shkresën nr. {***} prot., datë 23.04.2019, dhe sipas informacionit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, nuk ka pasur ankim. KLP-ja ka vlerësuar sjelljen e prokurorit si shmangie nga përgjegjësia për përmbushjen e funksionit të tij, shoqëruar me pamundësinë e të paraburgosurit për t'u dëgjuar për kërkesën e tij për t'u liruar, me dijeninë e qartë për gjendjen e procedimit dhe kohën e vuajtjes në paraburgim të të pandehurit, sjelljen jo-etike dhe largimin në mënyrë demonstrative nga seanca gjyqësore, duke konkluduar për shkelje të rëndë profesionale dhe etike, sipas parashikimeve të nenit 148/d, pika 2, germa "a" e Kushtetutës.

15.4.1.2 Magjistrati në ankim nuk shprehet për sa ka analizuar dhe konkluduar KLP-ja, por ngre pretendimin: *[...] aferë korruptive e avokat Th. S., prokuror S. K.t dhe gjyqtar Artan Jahollarit, me redaktorin e emisionit "{***}" kanë marrë shuma të mëdha financiare për të liruar nga burgu këtë person*[72], ndërsa në parashtrime pretendon se ky shtetas është rigjykuar dhe dënuar me të njëjtën masë dënimi që i ka dhënë ai si prokuror në vitin 2016.

15.4.1.3 Kolegji vlerëson se konkluzioni i KLP-së është i bazuar në ligj e në prova, si dhe çmon se pretendimet e magjistratit për këtë procedim penal, janë jashtë kompetencave të Kolegjit për shqyrtimin e çështjeve të juridiksionit disiplinor dhe në thelb nuk japin asnjë argument për të vlerësuar pretendimin e ngritur prej tij në pikënisje të ankimit se: *të gjitha shkeljet disiplinore janë fiktive dhe të rreme.*

15.4.1.4 Në gjykimin me të pandehur R. A., në seancat gjyqësore të datave 27.12.2019 dhe 05.01.2020, objekt gjykimi "zëvendësimi i masës së sigurimit arrest në burg", i vendosur me afat 20-ditor sipas vendimit të gjykatës, datë 18.12.2019, prokurori Shkëlqim Kokona është bërë shkak për shtyrjen e seancës së datës 27.12.2019, duke deklaruar se do të paraqiste kërkesë për përjashtimin e gjyqtares për arsye anshmërie, por që nuk e ka paraqitur dhe, me gjithë njoftimin zyrtar, nuk është paraqitur në seancën e datës 05.01.2020, zhvillimi i së cilës e kishte humbur objektin e saj sipas parashikimeve të nenit 261/1/ç të K.Pr.Penale.

15.4.1.5 Lidhur me përfaqësimin e akuzës në gjykimin e të pandehurit O. V., seancat gjyqësore të datave 11.02.2021 dhe 14.04.2021, ku prokurorit Shkëlqim Kokona i është kërkuar nga gjykata të jepte konkluzionet, por që ai nuk i ka dhënë, dhe nisur nga shkresa e gjykatës dhe kërkesa me shkrim e prokurorit për dorëheqje për shkak se "tre gjyqtarët që gjykojnë këtë procedim, janë të paaftë mendërisht (s'kanë kapacitet profesional dhe jo mjekësor)", drejtuesi i Prokurorisë më datë 21.04.2021, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit Shkëlqim Kokona. Dorëheqja është kërkuar nga prokurori Kokona pas rrëzimit të kërkesave së tij për revokimin e vendimit për gjykim të shkurtuar dhe riçeljen e hetimit gjyqësor, në seancën e datës 11.02.2021 dhe për tërheqjen e akteve në bazë të nenit 377 të K.Pr.Penale në seancën e datës 27.01.2021. Nga ana e drejtuesit të

[72] *Referojuni pikave 5, 27, 40, 43, 44 dhe 45 të ankimit.*

Prokurorisë N. H., në vendimin e zëvendësimit është konstatuar fakti se nuk kishte shkaqe për pranimin e dorëheqjes së prokurorit Shkëlqim Kokona, por se ishte i detyruar për shkak të sjelljes së pajustifikuar të prokurorit, duke arsyetuar se: *referuar problematikës së ngritur nga trupa gjykuese, sjelljen jokorrekte dhe etike të prokurorit Shkëlqim Kokona, sjellje e cila është bërë shkak për shtyrjen më shumë se një herë të seancave gjyqësore dhe bërë shkak për zvarritjen e këtij gjykimi, sjellje e cila cenon figurën e magjistratit, dinjitetin dhe funksionet e tij në ushtrimin e detyrës pasi në mënyrë të pajustifikuar ka kryer sjellje të papërshtatshme gjatë ushtrimit të detyrës, vlerësoj se në këto kushte është i nevojshëm zëvendësimi i prokurorit Shkëlqim Kokona me një prokuror tjetër*. KLP-ja ka konkluduar se rrëzimi i kërkesave të prokurorit gjatë gjykimit nuk legjitimon kërkesën e tij për dorëheqje të gjyqtarëve me shkakun e paaftësisë së tyre, kërkese e cila fyen trupën gjyqësore dhe për pasojat e ardhura nga veprimet e tij, ka vlerësuar se sjelljet e prokurorit përbëjnë shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, germa "ç", pika 2, germa "dh" e ligjit 86/2016.

15.4.1.6 Magjistrati pretendon se nuk ka qenë dakord të pranohej gjykimi i shkurtuar, pasi duhej marrë akti mjeko-ligjor që nuk ishte futur në dosje, ndërsa në parashtrime ngre pretendimin se është zëvendësuar me kërkesën e tij për shkak se gjykata nuk merrte si provë aktin mjeko-ligjor.

15.4.1.7 Kolegji vlerëson se kuadri ligjor penal përcakton qartë kompetencat e prokurorit në ushtrim të funksionit të tij, detyrimin e tij për të respektuar gjykatën dhe vendimmarrjen e saj. Edhe përmes këtij pretendimi në ankim, të cilin Kolegji e vlerëson të pambështetur në ligj, dëshmohet kryerja me vetëdije të plotë e sjelljeve në shkelje të ligjit. Lidhur me pretendimin për zëvendësimin me kërkesë të tij, Kolegji e vlerëson të pabazuar, pasi sikundër rezulton nga aktet, shkaku i zëvendësimit ka qenë zvarritja e gjykimit dhe cenimi i figurës së magjistratit për shkak të sjelljeve dhe qëndrimeve të tij. Kolegji vlerëson se konkluzioni i KLP-së është i bazuar në ligj e në prova.

15.4.1.8 KLP-ja ka konstatuar se prokurori Shkëlqim Kokona, pa shkaqe të arsyeshme, nuk është paraqitur në seancat e datave 03.01.2021 dhe 04.01.2021 për gjykimin e çështjes ndaj të pandehurit E. K., me objekt "zbatimin e masës së sigurimit", sipas parashikimeve të nenit 248 të K.Pr.Penale. Drejtuesi i Prokurorisë, në autorizimin për caktimin e prokurorit zëvendësues, ka arsyetuar se prokurori Shkëlqim Kokona është njoftuar për të dyja seancat dhe nuk ka pranuar të paraqitej në gjykatë, shkak për të cilin është bërë zëvendësimi i tij. Për shkak të llojit të gjykimit, sipas parashikimit të nenit 248/1 të K.Pr.Penale, gjykata, për verifikimin e masës, duhet të procedojë brenda 5 ditëve nga zbatimi i masës. Për të njëjtën çështje, KLP-ja ka konstatuar se nga ana e prokurorit është vonuar të bëhet shpallja e moskompetencës lëndore, duke kryer veprime hetimore gjatë periudhës që duhej të kishte shpallur moskompetencën. KLP-ja ka konkluduar se sjelljet e prokurorit vlerësohen shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, germat "ç", "dh" dhe "g" të ligjit 86/2016.

15.4.1.9 Magjistrati në ankim shprehet se: *çështja është fituar prej tij, aktualisht janë në Gjykatën e Posaçme për verifikim, mungesat në verifikimin e masës me leje në Tiranë. Veprimet për arritjen*

e marrëveshjes me prokurorin, datë 05.11.2019 dhe 20.11.2019. Propozimi për marrëveshje me prokurorin[73].

15.4.1.10 Kolegji çmon të evidentojë që prej magjistratit nuk qartësohen arsyet për të cilat ai kundërshton konkluzionin e KLP-së. Për pretendimin se mungesat në seanca vijnë për shkak se ka qenë me leje në Tiranë, Kolegji e vlerëson të pabazuar nga përmbajtja e vendimit objekt ankimi, si dhe për faktin se prej tij nuk është paraqitur asnjë provë për sa pretenduar, për rrjedhojë ky pretendim mbetet deklarativ.

15.4.2 KLP-ja, ka konstatuar se gjatë përfaqësimit në gjykim të çështjes në ngarkim të të pandehurit G. M., nga të dhënat e marra gjatë procedimit nuk konstatohet e provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se prokurori zëvendësues në gjykim, Shkëlqim Kokona, të ketë vepruar përtej bindjes së tij të brendshme, të garantuar nga neni 3 i ligjit 96/2016, për të ndryshuar akuzën e ngritur nga prokurori i çështjes. Në aspektin formal procedural, rezulton se ndërhyrja e prokurorit për ndryshimin e akuzës është bërë pas pyetjes së një dëshmitareje, e cila nuk ishte pyetur nga prokurori S. K., dhe në vijim ka vijuar normalisht, me dhënien e kohës së mjaftueshme të të pandehurit për t'u njohur me ndryshimin e akuzës. Në kushtet kur çështja është duke u gjykuar në Gjykatën e Apelit Korçë, i mbetet kësaj gjykate për të vlerësuar lidhur me akuzën.

15.4.2.1 Në ankim, për këtë çështje, magjistrati mjaftohet me shpjegimin: *çështje e prokuror S. K. Është dërguar në gjykatë për kallëzim të rremë. Jam caktuar me autorizim dhe kam mbajtur të njëjtin qëndrim, por për vjedhje. Gjykata ka dhënë vendimin e saj. Prokurori S. K. e ka akuzuar se ka ndryshuar padrejtësisht akuzën nga kallëzim i rremë në vjedhje*[74]. Kolegji vlerëson se magjistrati nuk ka shtjelluar dhe as ka dhënë argumente për të kundërshtuar konkluzionin e KLP-së, që nuk rezulton ta ketë ngarkuar me përgjegjësi, për rrjedhojë nuk çmon të analizojë më tej lidhur me këtë çështje.

15.4.3 KLP-ja, lidhur me çështjen me të pandehur A. F., duke pasqyruar përmbajtjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë që ka shqyrtuar ankimin ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, dhe ka vendosur kthimin e akteve për gjykim ku është arsyetuar se: *[...] prokurori i çështjes edhe pse ka paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes për gjykim, nuk ka respektuar urdhërimet e vendimit nr. {***}, datë 01.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 02.11.2018, të Gjykatës së Apelit Korçë, por njëkohësisht ka anashkaluar edhe vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq, në ngarkim të të pandehurit A. F. [...],* duke konkluduar se sjellja e prokurorit Shkëlqim Kokona përbën shkelje, në periudhën, referuar në nenin 148/d, pika 2, germa "a" e Kushtetutës. KLP-ja, duke vlerësuar se sjellja e prokurorit në këtë çështje, e marrë si sjellje më vete, në kushtet kur në përfundim çështja është pushuar nga ana e gjykatës, referuar faktit të mosprovueshmërisë së

[73] *Shih pikat 8 dhe 60 të ankimit.*
[74] *Shih pikat 14 dhe 28 të ankimit.*

kryerjes së veprës penale, ka konkluduar se nuk përbën shkelje të rëndë profesionale sipas parashikimit kushtetues.

15.4.4 Kolegji vlerëson se KLP-ja nuk e ka ngarkuar magjistratin me përgjegjësi disiplinore për këtë çështje, i cili në ankim është shprehur: *çështja është fituar prej tij, pushuar nga Gjykata e Apelit për mungesë të veprës penale*. Në këto kushte, Kolegji çmon se magjistrati nuk ka ngritur shkak ankimi për konkluzionin e KLP-së për këtë çështje.

15.5 *Refuzimi me anë të mosveprimit për të marrë masa për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit për vendimet e gjykatës për të cilat parashikohet ekzekutim i menjëhershëm*

15.5.1 KLP-ja ka konstatuar se nga prokurori Shkëlqim Kokona nuk është nxjerrë urdhri i ekzekutimit për vendimin penal nr. {***}, datë 16.12.2019, për të pandehurin M. M., me masë sigurimi arrest në burg, i cili në datën 16.01.2020, kur është depozituar vendimi i gjykatës për ekzekutim, kishte tejkaluar masën e dënimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë në raport me kohën e vuajtur në paraburgim dhe, në kushtet kur vendimi i dënimit nuk kishte marrë ende formë të prerë, KLP-ja ka konkluduar se sjellja e prokurorit Shkëlqim Kokona përbën mospërmbushje të pajustifikuar të funksionit si prokuror, sipas parashikimeve të nenit 24 të K.Pr.Penale, dhe shkelje sipas nenit 102, pika 1, germa "ç" e ligjit 96/2016.

15.5.2 Gjithashtu, KLP-ja ka konstatuar se nga prokurori Shkëlqim Kokona nuk është nxjerrë urdhri i ekzekutimit të masës mjekësore mjekim i detyruar ambulator, i vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec me vendimin nr. {***}, datë 09.01.2020, për shtetasin N. T., vendim i cili është protokolluar në zyrën e prokurorisë më datë 09.01.2020, ora 15:30 dhe është menjëherë i zbatueshëm pas shpalljes së vendimit nga ana e gjykatës[75]. Urdhri është nxjerrë nga drejtuesi i Prokurorisë më datë 10.01.2020. KLP-ja ka konkluduar se sjellja e prokurorit Shkëlqim Kokona, duke mos vepruar për nxjerrjen e urdhrit, përbën mospërmbushje të pajustifikuar të funksionit si prokuror, sipas parashikimeve të nenit 24 të K.Pr.Penale, dhe shkelje sipas nenit 102, pika 1, germa "ç" e ligjit 96/2016.

15.5.3 KLP-ja ka konstatuar se për periudhën 2019-2021, rezulton e provuar se për 28 raste, prokurori Shkëlqim Kokona nuk ka nxjerrë urdhra për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të dënimit me burgim, për të cilat është aplikuar pezullimi i ekzekutimit me kusht, sipas nenit 59 të Kodit Penal[76] dhe urdhrat e ekzekutimit janë nxjerrë nga drejtuesi i prokurorisë, sipas kohës apo nga prokuror tjetër. Në referim të urdhrit të drejtuesit të Prokurorisë nr. 3, datë 20.03.2018, lidhur me organizimin e procedurave të ekzekutimit, parashikohet se prokurore e ekzekutimeve është D. B., e cila nxjerr urdhrat e ekzekutimit të vendimeve penale, përveç të atyre urdhrave që nxirren posaçërisht nga prokurorët e seancës së parashikuar. Sipas informacionit të drejtuesit të

[75] *Neni 46 i Kodit Penal mbi masat mjekësore dhe neni 462 i Kodit të Procedurës Penale mbi ekzekutimin e vendimeve penale menjëherë pas shpalljes.*
[76] *Shih pikat 1.28.2 dhe 1.28.3 të vendimit të KLP-së, ku janë pasqyruar të dhënat për urdhrat për ekzekutimin e vendimeve me kusht.*

Prokurorisë N. H., ky urdhër i nxjerrë në bazë dhe për zbatim të ligjit të organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë, me qëllim rregullimin e procedurës edhe nën dritën e ndryshimeve të nenit 59 të Kodit Penal, i është vënë në dispozicion edhe prokurorit Shkëlqim Kokona, jo kundrejt nënshkrimit, si të gjithë prokurorëve të tjerë. Referuar përmbajtjes së urdhrave të cituar në vendimin e KLP-së, rezulton se janë nxjerrë nga drejtuesi i Prokurorisë, ndërkohë që prokuror i çështjes figuron Shkëlqim Kokona. KLP-ja ka konkluduar se nga prokurori Shkëlqim Kokona, për rastet e mosnxjerrjes së urdhrave të ekzekutimit, është kryer shkelja e mospërmbushjes së funksionit të prokurorit në mënyrë të pajustifikuar dhe të përsëritur, e parashikuar në nenin 102, pika 1, shkronja "ç" e ligjit 96/2016.

15.5.4 Magjistrati pretendon se për ekzekutimet e vendimeve për të dënuarit me kusht, ka urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, prokurore e ekzekutimeve ka qenë e caktuar D. B., dhe janë ekzekutuar[77]. Për vendimin penal nr. {***}, datë 16.12.2019, në ngarkim të M. M., magjistrati pretendon për *shpifje* dhe se urdhri i ekzekutimit është nxjerrë nga titullari me tri ditë vonesë, prokurore e caktuar për ekzekutim ka qenë D. B.. Për vendimin nr. {***}, datë 9.01.2020, për zëvendësimin e masës mjekësore për shtetasin N. T., magjistrati gjithashtu pretendon se urdhri është nxjerrë nga titullari, prokurore për ekzekutim ka qenë D. B..

15.5.5 Kolegji, nga aktet në fashikuj, vëren se në 28 urdhrat e ekzekutimit, prokuror i çështjes figuron Shkëlqim Kokona dhe sipas urdhrit të drejtuesit të Prokurorisë nr. 3, datë 20.03.2018, prokurorja e ekzekutimeve D. B. nuk ka qenë e ngarkuar për të nxjerrë urdhrat e përcaktuar për t'u nxjerrë nga prokurorët e seancës të parashikuar, në këtë rast nga prokurori Shkëlqim Kokona[78]. Sa i përket pretendimit për vendimin penal nr. {***}, datë 16.12.2019, në ngarkim të M. M., nga përmbajtja e dy procesverbaleve të mbajtura nga kryesekretarja dhe sekretarja e Prokurorisë, Kolegji konstaton se prokurori Shkëlqim Kokona është njoftuar në dy data për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit [15.01.2020 dhe 16.01.2020], refuzuar prej tij dhe nga deklarimi i prokurorit S. K., ky i fundit shprehet se megjithëse pa ndonjë arsye për refuzim nga ana e prokurorit Kokona, për shkak të mosveprimit të tij, ka qenë i detyruar të bënte urdhrin e ekzekutimit duke vajtur enkas nga Tirana. Për nxjerrjen e urdhrit në rastin e vendimit nr. {***}, datë 9.01.2020, rezulton se prokurori Kokona në mënyrë të vullnetshme është larguar për në Tiranë[79]. Në këtë situatë faktike të provuar gjatë kryerjes së hetimit disiplinor, Kolegji vlerëson se magjistrati tenton të shtrembërojë rrethanat që kanë lidhje me çështjen, për rrjedhojë e vlerëson të pabazuar pretendimin e tij.

---

[77] Referoju pikave 12 dhe 38 të ankimit.

[78] Ligji nr. 8331, datë 21.04.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", i ndryshuar, në nenin 13 parashikon se prokurori i çështjes ka detyrimin e nxjerrjes së urdhrit të ekzekutimit pasi ai merr menjëherë dijeni për vendimin e gjykatës dhe duhet të marrë masat përkatëse për ekzekutimin e tij. Referuar nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale, vendimi është menjëherë i zbatueshëm pas shpalljes së tij nga ana e gjykatës.

*[79] Referoju procesverbalit të mbledhjes me nr. {***} prot., datë 21.01.2020.*

15.6 *Shkelje të përsëritur dhe të rëndë të rregullave të solemnitetit, rregullave të mirësjelljes në marrëdhëniet me palët, me drejtuesit e prokurorisë, me gjyqtarët, me oficerë të policisë gjyqësore, si dhe me personelin e administratës së prokurorisë dhe të gjykatës*

15.6.1 KLP-ja, për seancën e datës 07.07.2021, çështja penale në ngarkim të së pandehurës D. H., akuzuar për veprën penale "falsifikim i dokumenteve" dhe "përvetësim i titullit apo detyrës shtetërore", parashikuar nga nenet 186, 187 dhe 246/2 të Kodit Penal, nga aktet në dosje ka konstatuar se prej magjistratit është komunikuar në mënyrë joetike me avokaten dhe të pandehurën. Komunikimi i prokurorit Kokona në këtë seancë pasqyrohet në paragrafin 1.39.1 të vendimit.

15.6.1.1 Magjistrati, në ankim dhe në parashtrime, në mënyrë të përsëritur referon disa pretendime lidhur me këtë çështje: aferë korruptive të gjyqtares E. M., pushuar padrejtësisht çështjen, fituar prej tij dhe dënuar me burg nga Gjykata e Shkallës së Parë Pogradec, për dezinformacion, se nuk duhej të kthehej dosja nga SPAK, konfliktin e kompetencës e zgjidh Prokurori i Përgjithshëm, duke referuar edhe emra të shtetasve që rezultojnë të kenë lidhje me këtë procedim, po që sipas tij kanë lidhje politike e interesash[80].

15.6.1.2 Kolegji, nga shqyrtimi i vendimit objekt ankimi, vlerëson se komunikimi i magjistratit me përdorimin kundrejt së pandehurës të shprehjeve, si: *[...] çohu në këmbë kur flet [...] ajo nuk u çua në këmbë kur fliste me ju dhe kjo është skandal, fyen trupin gjykues [...],* është i papërshtatshëm, jokorrekt, me ndikim në miradministrimin e drejtësisë nga gjykata dhe në kundërshtim me "Rregullat mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve"[81]. Pretendimet e magjistratit që dëshmohen si opinione të tij, vlerësohen prej Kolegjit se nuk mund të justifikojnë sjelljen e tij në shkelje të rregullave të etikës, gjatë ushtrimit të funksionit të prokurorit për përfaqësimin e akuzës në gjykatë.

15.6.2 KLP-ja, për seancën e datës 19.04.2021, çështja penale në ngarkim të shtetasit E. J., me objekt "lejim i ekstradimit për jashtë shtetit", ka konstatuar komunikimin joetik të prokurorit Shkëlqim Kokona me mbrojtjen, duke analizuar debatin e zhvilluar në pikën 1.40 të vendimit.

15.6.2.1 Magjistrati nuk ngre asnjë pretendim lidhur me sa pasqyruar në vendimin e KLP-së për zhvillimin e seancës, kurse në ankim shprehet: *Ekstradimi i E. J., avokate A. D., asistente e P. S., eksponent i krimit të organizuar në drejtësi, ka liruar dhjetëra hajdutë dhe vrasës nga burgu për llogari financiare dhe politike. Pjesëtar i kioskës mafioze të partisë në pushtet*[82], ndërsa në parashtrime pretendon se ka kërkuar deklarimin fajtor të këtij shtetasi, gjykata e ka deklaruar fajtor dhe vendimi është në fuqi.

---

[80] *Shih ankimin "Analiza e provave dhe kundërshtimi i tyre për hetimin administrativ", pikat 2, 21, 24 dhe 25, 52 të tij, dhe pikën 18 të parashtrimeve të ankuesit.*
[81] *Miratuar me urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. {***}, datë 19.06.2014.*
[82] *Shih pikën 53 të ankimit.*

15.6.2.2 Kolegji, nga shqyrtimi i vendimit vëren se për sa shprehur prej magjistratit në ankim, janë deklaruar prej tij edhe në seancën gjyqësore, në të cilën gjykata është detyruar të ndërhyjë vazhdimisht për të vendosur rregullin në funksion të vijimit të gjykimit. Kolegji vlerëson se sjellja e magjistratit vjen në shkelje të hapur të parashikimeve të ligjit 96/2016, nenit 4, "Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes", dhe akteve të dala në bazë e për zbatim të tij, me pasojë ndikimin në miradministrimin e drejtësisë nga gjykata.

15.6.3 KLP-ja, për seancën e datës 13.04.2021, çështja penale me të pandehur J. M., akuzuar për veprën penale "Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur", parashikuar nga neni 103/1 i Kodit Penal, ka konstatuar komunikimin joetik të prokurorit Shkëlqim Kokona me mbrojtjen, pjesë nga procesverbali i seancës është pasqyruar në pikën 1.41 të vendimit.

15.6.3.1 Magjistrati pretendon se është zhvilluar debat normal, pa ngritur pretendime mbi sa pasqyruar në vendimin e KLP-së, objekt ankimi.

15.6.3.2 Kolegji e vlerëson të pabazuar pretendimin e magjistratit, pasi nga procesverbali i seancës, pasqyruar dhe analizuar në vendim, komunikimi i tij është në fyerje të dinjitetit dhe personalitetit të mbrojtjes, me përdorimin e shprehjeve, si: *[...] ty nuk të merret vesh çfarë shkruan [...] ia bëjnë të tjerët hartimet dhe kjo vjen dhe i lexon [...] nuk merrem dot me të tillë të paaftë [...] në qoftë se e lejoni të lexojë atë që përgatisin të tjerët, unë do të kërkoj përjashtimin e saj [...] vijnë nga rruga dhe lexojnë dorëshkrimet e të tjerëve [...]*. Për shkak të komunikimit të tij dhe ndërhyrjeve të vazhdueshme gjatë fjalës së mbrojtjes, gjykata ka ndërhyrë disa herë duke i tërhequr vëmendjen prokurorit dhe duke u shprehur që në rast të vijimit të ndërhyrjes dhe mosbindjes ndaj urdhrave të saj do të ndërpriste shqyrtimin gjyqësor. Sa më sipër, Kolegji vlerëson të pabazuar pretendimin i magjistratit, për sa provohet se sjellja e tij vjen në kundërshtim me parashikimet e nenit 4 të ligjit 96/2016.

15.6.4 KLP-ja, lidhur me zhvillimin e seancës gjyqësore të datës 11.01.2021, çështja penale në ngarkim të së pandehurës M. S., akuzuar për veprën penale "Fyerja e gjyqtarit", parashikuar nga neni 318 i Kodit Penal, ka konstatuar komunikimin joetik të prokurorit Shkëlqim Kokona me mbrojtjen dhe pjesë nga procesverbali i seancës është pasqyruar dhe analizuar në pikën 1.42 të vendimit.

15.6.4.1 Magjistrati në ankim mjaftohet me pretendimin: *deklaratë politike e avokates, provokim i hapur, vendim fajësie nga gjykata, fiton prokuroria*[83], në parashtrime pretendon se ka kërkuar deklarimin fajtor të së pandehurës, gjykata e ka dënuar me gjobë, vendimi është në fuqi.

15.6.4.2 Kolegji vëren se: *së pari*, prokurori është i detyruar që për përfaqësimin e akuzës në gjykim të ushtrojë funksionin e tij vetëm mbi bazën e vlerësimit të saktë të fakteve, në përputhje me kuptimin dhe zbatimin e drejtë të ligjit; *së dyti*, nga sa pasqyruar në vendim, komunikimi i

[83] *Shih pikën 55 të ankimit.*

magjistratit vjen në shkelje të parashikimeve ligjore për ushtrimin e funksionit të prokurorit në përfaqësimin e akuzës në gjykim dhe në shkelje të rregullave të etikës me adresimin për palën, mbrojtjen e saj dhe gjykatën *[...] një inskenim i krijuar nga kjo provokatorja M. S. [...] avokatja na bëri një parashtrim antiligjor, kriminal [...], kërkoj përjashtimin tuaj si gjyqtar që e lejuat një parashtrim të tillë [...]*. Kolegji gjithashtu konstaton se për shkak të deklarimit të prokurorit me kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit, gjykata ka ndërprerë seancën për t'i dhënë kohë për paraqitjen e kërkesës, në vijim janë caktuar disa seanca, të cilat nuk janë zhvilluar për mosparaqitje të palëve, dhe në seancën e radhës të zhvilluar më datë 22.02.2021, prokurori Shkëlqim Kokona është shprehur se është tërhequr nga kërkesa e tij, duke u shprehur se avokatja mbrojtëse është në kushtet e shpërdorimit të detyrës. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se sjellja dhe qëndrimi i prokurorit, me pasojë zvarritjen e gjykimit, vijnë në kundërshtim me parashikimet ligjore për ushtrimin e funksionit dhe me rregullat e etikës dhe, për rrjedhojë, pretendimi i magjistratit është i pabazuar.

15.6.5 KLP-ja, për seancën e datës 22.06.2021, për shqyrtimin e kërkesës së prokurorit Shkëlqim Kokona me të pandehur A. P., ka konstatuar sjellje joetike të prokurorit me mbrojtjen dhe gjykatën.

15.6.5.1 Magjistrati pretendon se *avokati i pranishëm gjatë veprimeve policore, pretendonte se veprimet ishin të kundërligjshme*.

15.6.5.2 Duke evidentuar komunikimin e prokurorit të pasqyruar në vendim, *[...] avokati duke bërë ndërhyrjen e poshtër që bën gjithmonë [...] paraqitet një avokat që është i paaftë mendërisht [...] nuk je mirë nga mendtë, e di unë kush të përdor ty [...] të lutem shumë, kërkoj përjashtimin e avokatit se nuk është mirë nga mendtë [...] kur e lejon atë t'i të flasë broçkulla [...]*, Kolegji vlerëson se sjellja e prokurorit vjen në shkelje të rëndë të rregullave të etikës dhe të solemnitetit, dhe pretendimi i tij është i pabazuar.

15.6.6 KLP-ja ka konstatuar se në seancën e datës 04.02.2020, me të pandehur R. R. dhe S. B., me objekt "Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq", ka konstatuar sjellje joetike të prokurorit me palën.

15.6.6.1 Magjistrati pretendon se *prej tij nuk është përdorur asnjë fjalë fyese ndaj të pandehurës dhe aktorëve të tjerë në proces, i cili ka qenë normal.*

15.6.6.2 Kolegji në analizë të sa pasqyruar në vendim lidhur me zhvillimin e kësaj seance, duke konstatuar komunikimin e magjistratit me shprehje, si: *[...] përndryshe do e hajë edhe nga unë si prokuror [...] a e kupton që ky është veprim mafioz që e lejon në sallë gjyqi, ajo i bën presion prokurorit [...]*, vlerëson të pabazuar pretendimin e magjistratit, për sa provohet se sjellja e tij vjen në kundërshtim me parashikimet e nenit 4 të ligjit 96/2016.

15.6.7 KLP-ja ka konstatuar thyerje të rregullave të etikës me përdorimin e fjalëve fyese nga ana e prokurorit Shkëlqim Kokona përkundrejt avokat G. B. në seancat e datave 16.01.2020, 20.01.2020 dhe 22.01.2020, me të pandehur B. D. dhe E. O.; në seancën e datës 23.06.2020, me

të pandehur K. C.; në seancën e datës 09.07.2020, me të pandehur M. P.; në seancën e datës 28.09.2020, me të pandehur M.M.; në seancën e datës 29.09.2020, me të pandehur V. M..

15.6.7.1 Magjistrati pretendon se nuk ka pasur asnjë fyerje nga ana e tij për avokatin G. B., është provokuar nga avokati, dhe se dosja e ish-prokuror E. P., lënë qëllimisht pa vendim zgjatjeje prej tij, çështje e fituar përfundimisht prej tij, autori i deklaruar fajtor nga gjykata. Ndërsa incidenti më datë 16.01.2020, çështja në ngarkim të të pandehurit B. D., është shpifje, dhe nuk ka padi apo kallëzim penal nga ana e avokatit[84].

15.6.7.2 Nga përmbajtja e vendimit dhe aktet e administruara në fashikuj, Kolegji konstaton komunikim joetik të prokurorit Shkëlqim Kokona ndaj avokatit G. B., me shprehje, si: *mos mashtro, të bëj atë që s'ta pret mendja, mos m'u trego trim mua [...]*, komunikim për të cilin i është tërhequr disa herë vëmendje nga ana e gjykatës, sjellje e cila ka sjellë si pasojë edhe ndërprerjen e seancës. Për komunikimin joetik nga ana e prokurorit përpara zhvillimit të seancës së datës 16.01.2020, avokati G. B. i është drejtuar me memo drejtuesit të Prokurorisë, për shkak të situatës së zhvilluar në korridoret e gjykatës, në prani të palëve, ku bëhen ofendime të rënda me një fjalor të papranueshëm, si dhe kërcënime prej prokurorit. Në memo avokati kërkon përjashtimin e prokurorit Shkëlqim Kokona nga çështjet ku është përfaqësues i palëve, me qëllim shmangien e situatave që mund të precipitojnë, jo për shkak të tij, pasi nuk ka pasur asnjë konflikt personal me prokurorin, por për shkak të sugjerimit të prokurorit për "zgjidhjen me kanun" të konfliktit. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimet e magjistratit janë të pabazuara.

15.6.8 KLP-ja ka konstatuar shkelje të përsëritur dhe të rëndë të rregullave të mirësjelljes në marrëdhënie me drejtuesit e prokurorisë, të cilat në mënyrë të përmbledhur pasqyrohen si vijojnë. Me drejtuesin e prokurorisë, S. K., në datën 22.01.2020, në ambientet e prokurorisë, gjatë orarit zyrtar, sjellja e magjistratit është manifestuar me përdorimin e fjalëve: *bën mbledhje për mua, do ta bëj si A. Ç., do të [...]*, të shoqëruara me veprime fizike duke tentuar për ta goditur dhe shtyrë; në datën 31.10.2019, magjistrati ka debatuar me një subjekt procedural e më tej edhe me drejtuesin e Prokurorisë, duke e fyer më fjalë të ulëta në nderin e anëtarëve të familjes. Nga momenti i marrjes së detyrës prej drejtuesit të Prokurorisë, N. H., në komunikimet ndaj tij magjistrati ka përdorur në vijimësi tone të larta e madje edhe fjalor fyes në drejtim të nderit të familjes, qëndrime që evidentohen edhe me memon e datës 29.04.2021, ku shprehet: *me kryesekretaren sot më keni venë në dijeni të dy paçavuret të përpiluara prej jush për dy dosje [...] duke mos pasur kohë fizike për të lexuar letrat tuaja, po ju them atë proverbin shkodran [...]. "Letrat tuja plot sajdi i kam varë unë në zyrtare dhe veç kur më vinte më [...] më vinte mend për zotnin tande". Për sa i përket dosjes në hetim që më sugjeroje në mënyrë të kundërligjshme ta pushoja, po të paralajmëroj se po e bëre për ndonjë të rëndësishme do të denoncoj për ndikim të paligjshëm, krim ky i parashikuar nga Kodi Penal.* Në rastin e ankimeve drejtuar Gjykatës së Apelit për çështjen në ngarkim të të pandehurit L. F. dhe A. K., evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë jo vetëm profesionin, por

[84] *Shih pikat 3, 16 dhe 59 të ankimit.*

edhe nderin dhe dinjitetin e gjyqtarëve: *gjyqtarja e influencuar nga qëndrimi i titullarit të prokurorisë, në mënyrë arbitrare ka vendosur kthimin e akteve [...] nga gjyqtarja është përdorur një mekanizëm korruptiv mjaft i zgjuar dhe stërholluar për të realizuar pretendimet e titullarit të prokurorisë [...] apriori kemi pretendimin se një mendje normale nuk diskuton faktin se nuk jemi para një që mund të vendoset kthimi i akteve dhe se vendimi është tërësisht klientelist dhe abuziv dhe të kundërshtosh këtë konkluzion është humbje kohe.*

15.6.8.1 KLP-ja ka konstatuar shkelje të përsëritur dhe të rëndë të rregullave të etikës në marrëdhënie me gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, E. M., L. K., A. P., A. J., po ashtu në marrëdhënie me oficerin e policisë gjyqësore, Sh. M., ndodhur në zyrën e magjistratit, me përdorimin prej tij të shprehjeve fyese dhe fjalëve të ulëta, situatë për të cilën oficeri tjetër i policisë gjyqësore B. T. është detyruar për të ndërhyrë për qetësimin e situatës. Gjithashtu, me kryesekretaren dhe ftuesen e prokurorisë, magjistrati ka demonstruar sjellje të papranueshme, komunikime me tone të larta, fyerje, përplasje dosjesh.

15.6.8.2 Magjistrati, për konfliktet me S. K., Dh. K., Sh. M., pretendon se asnjë prej tyre nuk ka bërë padi në gjykatë ose denoncim për fyerje, se fyerja për shkak të detyrës është shfuqizuar, dhe se janë shpifje të S. K. Magjistrati pretendon për shpifje lidhur me ankesën për fyerje ose kanosje nga gjyqtarja E. M., se nuk ka padi civile apo kallëzim penal nga kjo gjyqtare ndaj tij, si dhe shton se gjyqtarja është kallëzuar penalisht prej tij, sipas tij në rastin e aferës së A. K. dhe në pushimin e çështjes së D. H. Sipas tij, ka kaluar afati 6-mujor i procedimit nga data e konstatimit. Për gjyqtaren L. K., magjistrati pretendon se është përgjuar dhe provokuar me pyetje prej saj në seancën e datës 10.02.2020, çështja në ngarkim të të pandehurit B. S..

15.6.8.3 Kolegji vëren se sjelljet e prokurorit vijnë në shkelje të rregullave të etikës dhe sjelljes së prokurorëve, të parashikuara në nenin 4 të ligjit 96/2016, dhe janë totalisht të papranueshme për një prokuror në asnjë rast dhe asnjë rrethanë, për më tepër të kryera në prani edhe të shtetasve prezent, duke cenuar besimin e tyre te sistemi i drejtësisë. Nga deklarimet e gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, Kolegji konstaton se prej tyre është referuar lidhur me sjelljet joetike të magjistratit, në prezencë të palëve, por edhe me veprime të tij për t'u imponuar në ushtrimin e detyrës së tyre. Në mënyrë të vijueshme, në komunikimet e magjistratit evidentohet deklarimi prej tij për regjistrim të kallëzimeve penale, kryer këto edhe ndaj gjyqtarëve, sipas tij për të dëshmuar fuqinë e prokurorit, madje edhe ndaj sekretareve të gjykatës përkundrejt kryerjes së detyrës për kryerje të njoftimeve, duke u shprehur: *nuk ke punë të më marrësh në telefon, do të regjistroj procedim penal për keqpërdorim të thirrjeve telefonike*, sjellje që jo në pak raste, nga vendimi objekt ankimi, rezultojnë të jenë të bashkëshoqëruara me tone të larta komunikimi, deklarim për veprime korruptive të gjyqtarëve në prezencë të palëve dhe largimin në mënyrë demonstrative.

16 Ligji 96/2016, në nenet 3 dhe 4 të tij[85], parashikon vlerat themelore, standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes që magjistrati duhet të dëshmojë gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij, në funksion të garantimit, ruajtjes dhe forcimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Në referim të shkeljeve disiplinore të kryera në mënyrë të përsëritur prej magjistratit dhe pasojave të ardhura, momentit subjektiv të kryerjes së tyre, sjelljeve të përsëritura në shkelje flagrante të standardeve etike, rregullave të sjelljes dhe të moralit shoqëror, Kolegji, pas kontrollit dhe analizës së vendimit të KLP-së, çmon se veprimet/mosveprimet e sjelljet e ndërmarra nga ana e magjistratit Shkëlqim Kokona, në tërësinë e tyre përbëjnë shkelje të rënda profesionale dhe etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës dhe, të parashikuara si të tilla nga neni 148/d, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronja "b", nënpika "ii", neni 102, pika 1, shkronjat "ç", "d", "dh", "g" dhe neni 102, pika 2, shkronjat "a" dhe "dh" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, që në rastin konkret përbëjnë shkelje shumë të rëndë disiplinore, duke e bërë atë të padenjë për të vijuar ushtrimin e funksionit të prokurorit.

17 Sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë kriteret për caktimin e masës disiplinore, sipas nenit 115 të ligjit nr. 96/2016, për natyrën/llojin e shkeljeve disiplinore që referojnë në sjellje dhe veprime; kryerjen e shkeljeve disiplinore nga ana e magjistratit me dashje direkte; ekzistencën e rrethanave rënduese, duke theksuar se shkeljet janë të vazhdueshme duke vijuar me të njëjtën sjellje; përvojën e gjatë të magjistratit në sistemin e prokurorisë; cenimin e imazhit të sistemit të drejtësisë dhe besimit të publikut në këtë sistem; ekzistencën e rrezikut të shkaktuar nga shkelja disiplinore pasi sjellja e papërshtatshme e magjistratit subjekt hetimi disiplinor, rrezikon të ndiqet si shembull nga magjistratë të tjerë; krijimin e terrenit për sjellje të papërshtatshme dhe në raste të tjera të ngjashme, me rrezik serioz në besimin e publikut në administrimin e drejtësisë; mungesën e ndonjë arsyeje specifike që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit të prokurorisë, Kolegji arrin në konkluzionin se masa disiplinore "shkarkim nga detyra" e dhënë ndaj magjistratit nga KLP-ja, është në përputhje me parimin e ligjshmërisë, e bazuar në kritere objektive lidhur me rëndësinë e shkeljes disiplinore, e bazuar në kriteret e individualitetit dhe të proporcionalitetit, dhe e nevojshme për të përmbushur qëllimin e vetë ligjit.

---

[85] *Ligji 96/2016, në nenin 3, "Vlerat themelore", ndër të tjera, parashikon: "1. Magjistrati ushtron funksionet e tij, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin […]. 4. Magjistrati ushtron funksionet gjyqësore në mënyrë të paanshme, pa ndikim dhe pa paragjykime. 5. Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces. Magjistrati ushtron funksionet me drejtësi, në mënyrë korrekte, në kohë të arsyeshme, të ndërgjegjshme, të kujdesshme, të zellshme dhe sistematike, me objektivitet, vetëpërmbajtje dhe maturi"; ndërsa në nenin 4, "Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes", ndër të tjera, parashikon: "1. Magjistrati merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera edhe kur magjistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare. 2. Magjistrati merr të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar: a) dinjitetin dhe standardet e funksionit të tij; b) reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe atë të prokurorisë; c) statusin e funksionit të magjistratit".*

18 Në përfundim, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në analizën në tërësi të pretendimeve të kërkuesit, çmon se vendimi nr. 411, datë 17.12.2021, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë është i drejtë dhe i bazuar në ligj, dhe kërkesa e magjistratit Shkëlqim Kokona nuk duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i" e Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOSI:

Mospranimin e ankimit të magjistratit Shkëlqim Kokona kundër vendimit nr. 411, datë 17.12.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë "Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistratit Shkëlqim Kokona, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec".
Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 20.02.2023
Shpallur më 23.03.2023

GJYQTARE	**GJYQTARE**	**GJYQTARE**
Ina RAMA	**Mimoza TASI**	**Natasha MULAJ**
nënshkrimi	*nënshkrimi*	*nënshkrimi*
GJYQTARE	**GJYQTAR**	**KRYETARE**
Rezarta SCHUETZ	**Sokol ÇOMO**	**Albana SHTYLLA**
nënshkrimi	*nënshkrimi*	*nënshkrimi*